



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"
VLORE
ZYRA PROTOKOLL-ARKIVËS
Nr. 2285/Prot.
Datë: 29.12.2020

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. _____ Prot.

Vlorë më, 28. 12. 2020

VENDIM

Nr. 59, datë 28. 12. 2020

PËR
MIRATIMIN E PROGRAMIT TË RI TË STUDIMIT MASTER SHKENCOR NË
ADMINISTRIM PUBLIK


Në mbështetje të nenit 49, nenit 75 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 25 të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, VKM nr. 41, datë 24. 01. 2018 "Për elementët e programve të studimit të ofruara nga ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", Udhëzimit nr. 1, datë 14. 01. 2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar, si dhe shkresës nr. 2065 prot, datë 09. 12. 2020 të Dekanit të Fakultetit të Ekonomisë, në mbledhjen e datës 28. 12. 2020 Bordi i Administrimit


VENDOSI

1. Të miratojë propozimin për hapjen e programit të ri të studimit në ciklin e dytë të studimeve në Master Shkencor në Administrim Publik, miratuar me vendim Senati Akademik nr. 87, datë 29. 09. 2020, në Fakultetin e Ekonomisë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Dr. ERVIS MOCKA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I EKONOMISË
FAKULTETI I EKONOMISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I EKONOMISË
Nr. 2065
Data 08.12.2020

Nr. 116/5 prot.

Vlorë, më 09.12.2020

Lënda: Përcjellje për miratim të propozimeve mbi hapjen e programit të studimit Master Shkencor në "Administrim Publik" të ofruar nga Departamenti i Biznesit

ERVIS MOCKA
KRYETAR
BORDI I ADMINISTRIMIT, UV

Në mbështetje të **nenit 71** "Programet e studimit në institucionet e arsimit të lartë", **nenit 75** "Programet e ciklit të dytë të studimeve" të **Ligjit Nr. 80/2015** "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", **Udhëzimit Nr.1 Prot 315 datë 14.01.2020** "Për Dokumentacionin dhe Procedurat për Hapjen, Riorganizimin dhe Mbylljen e Institucionit të Arsimit të Lartë, Degëve të Tyre, Njësive Kryesore dhe Programeve të Studimit, si Dhe Për Ndarjen ose Bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë", dhe **Udhëzimit Nr.22, Prot 4669/1 datë 03/09/2020**, Për Disa Shtesa Dhe Ndryshime Në Udhëzimit Nr.1, datë 14.01.2020 "Për Dokumentacionin dhe Procedurat për Hapjen, Riorganizimin dhe Mbylljen e Institucionit të Arsimit të Lartë, Degëve të Tyre, Njësive Kryesore dhe Programeve të Studimit, si Dhe Për Ndarjen ose Bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë", Departamenti i BIZNESIT të Fakultetit të Ekonomisë në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë (UV) propozon hapjen e programit të studimit Master Shkencor në "Administrim Publik", sipas formatit të bashkëlidhur kësaj shkrese, konform Shtojcës 2 të Udhëzimit Nr.1 Prot 315 datë 14.01.2020.

DEKANI
PROF.DR.ALBEREQARRI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I EKONOMISË
DEPARTAMENTI I BIZNESIT

Nr. 110/4 prot.

Vlorë, më 09 . 12 .2020

Lënda: Përcjellje për miratim të propozimeve mbi hapjen e programit të studimit Master Shkencor në “Administrim Publik” të ofruar nga Departamenti i Biznesit

PROF.DR. ALBERT QARRI
DEKANI
FAKULTETI I EKONOMISË

Në mbështetje të **nenit 71** “Programet e studimit në institucionet e arsimit të lartë”, **nenit 75** “Programet e ciklit të dytë të studimeve” të **Ligjit Nr. 80/2015** “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, **Udhëzimit Nr.1 Prot 315 datë 14.01.2020** “Për Dokumentacionin dhe Procedurat për Hapjen, Riorganizimin dhe Mbylljen e Institucionit të Arsimit të Lartë, Degëve të Tyre, Njësive Kryesore dhe Programeve të Studimit, si Dhe Për Ndarjen ose Bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë” , dhe **Udhëzimit Nr.22, Prot 4669/1 datë 03/09/2020**, Për Disa Shtesa Dhe Ndryshime Në Udhëzimit Nr.1, datë 14.01.2020 “Për Dokumentacionin dhe Procedurat për Hapjen, Riorganizimin dhe Mbylljen e Institucionit të Arsimit të Lartë, Degëve të Tyre, Njësive Kryesore dhe Programeve të Studimit, si Dhe Për Ndarjen ose Bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë”, Departamenti i BIZNESIT të Fakultetit të Ekonomisë në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë (UV) propozon hapjen e programit të studimit Master Shkencor në “Administrim Publik”, sipas formatit të bashkëlidhur kësaj shkrese, konform Shtojcës 2 të . Udhëzimit Nr.1 Prot 315 datë 14.01.2020.

DREJTUESE E DEPARTAMENTIT TE BIZNESIT
Prof.Assoc. Fjoralba Vela

SHTOJCA 2

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

PROJEKT-PROPOZIM PËR HAPJE/RIORGANIZIM/MBYLLJE PROGRAMI STUDIMI

1. Institucioni/IAL Shkruani emrin e plotë të institucionit Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë (University of Vlorë "Ismail Qemali")	2. Aplikimi (zgjidh një): Program i ri ☒ ____ Riorganizim programi ____
3. Emërtimi i programit të propozuar për hapje/riorganizim Shkruani titullin e plotë të programit: Master Shkencor në "Administrim Publik"	
4. Semestri dhe viti akademik i hapjes Semestri I, viti akademik 2021-2022	
5. Të dhënat për aktin e hapjes/akreditimit të IAL dhe/ose njësisë kryesore që ofron programin e studimit. VKM Nr.105, date 28.02.1994 VBA Nr.71, date 21.09.2017	6. Vendimi i miratimit nga Senati Akademik Vendimi i miratimit nga Bordi Administrimit
7. Nëse është një program i përbashkët studimi identifikoj IAL-të bashkëpunuese dhe cito aktin e bashkëpunimit mes IAL-ve dhe marrëveshjen specifike për realizimin e programit të studimit.	
9. Programi ofrohet nga: Departamenti i <u>BIZNESIT</u> Fakulteti i EKONOMISË Kampusi/godina: Kampusi i Universitetit "Ismail Qemali" të Vlorës /Godina A	
10. Të dhëna mbi personat e kontaktit përgjegjës për programin e studimit: Emër, mbiemër: Fioralba VELA Pozicioni në IAL: Përgjegjese e Departamentit të Biznesit Tel: +355672035075 Email: fiorivela@yahoo.it, fioralba.vela@univlora.edu.al	
11. Deklaratë e titullarit të IAL për plotësimin e standardeve akademike dhe infrastrukturore, të parashikuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.	
12. Firma (emër / mbiemër) e titullarit të institucionit dhe vula e institucionit	

PËRSHKRIMI I PROGRAMIT TË PROPOZUAR PËR HAPJE/RIORGANIZIM

a) Të dhëna mbi programin e studimit:

Në këtë seksion duhet të përfshihen të dhëna mbi elementët e mëposhtëm:

- Lloji i programit.
- Njësia bazë / njësia kryesore ofruese e programit të studimit.
- Arsyetimi për nevojën e hapjes së programit (risia që sjell ky program).
- Përshkrimi i përgjithshëm i programit, misioni, qëllimi dhe objektivat e tij.

Studimet universitare në Evropë janë duke iu nënshtuar një reforme të thellë. Institucionet evropiane të arsimit të lartë kanë pranuar sfidën dhe kanë ndërmarrë një rol kryesor për ndërtimin e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë, nëpërmjet realizimit të procesit të Bolonjës. Organizimi i ri i kurseve të studimit në përputhje me Deklaratën e Bolonjës, krahas zëvendësimit të studimeve me dy nivele, thekson nevojën e rritjes së atraktivitetit ndaj Arsimit të Lartë.

Në mbështetje të nenit 71 “Programet e studimit në institucionet e arsimit të lartë”, nenit 75 “Programet e ciklit të dytë të studimeve” të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimit Nr.1 Prot 315 datë 14.01.2020 “Për Dokumentacionin dhe Procedurat për Hapjen, Riorganizimin dhe Mbylljen e Institucionit të Arsimit të Lartë, Degëve të Tyre, Njësive Kryesore dhe Programeve të Studimit, si Dhe Për Ndarjen ose Bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë” , dhe Udhëzimit Nr.22, Prot 4669/1 datë 03/09/2020, Për Disa Shtesa Dhe Ndryshime Në Udhëzimit Nr.1, datë 14.01.2020 “Për Dokumentacionin dhe Procedurat për Hapjen, Riorganizimin dhe Mbylljen e Institucionit të Arsimit të Lartë, Degëve të Tyre, Njësive Kryesore dhe Programeve të Studimit, si Dhe Për Ndarjen ose Bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë” ,Departamenti i BIZNESIT të Fakultetit të Ekonomisë në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë (UV) propozon hapjen e programit të studimit Master Shkencor në “**Administrim Publik**”, në realizim të nevojave që paraqiten në territory për rritjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të burimeve njerëzore të përfshira në mirëfunksionimin e aparatit dhe agjensive shtetërore, në funksion të ndryshimeve dhe zhvillimeve politike, ekonomike dhe shoqërore të vendit, të ndërgjegjësimit gjithnjë e në rritje që përfutuesit e shërbimeve publike shfaqin kundrejt cilësisë, të nevojës për të patur administratë publike me specialistë të aftë dhe të kualifikuar, të zhvillimit të vrullshëm teknologjik si instrument që ndihmon në organizimin, funksionimin e sektorit publik dhe ofrimin e shërbimeve duke shmangur burokracitë.

Gjithashtu në ligj theksohet që arsimit të lartë duhet të mbështetë prioritetet strategjike dhe interesat e zhvillimit të vendit.

Një objektivi i tillë do të ishte shtimi dhe Masteri Shkencor në “Administrim Publik” që në propozojmë, Por me tepër, kjo kurrikul e re do të shenojë një vazhdimësi të traditës dhe eksperiencës 10 vjeçare që Departamenti i Biznesit ka krijuar në ofrimin e programeve me fokus administrimin publik, Referuar programit Master Profesional në Administrim publik, i cili ka qenë i përzgjedhur nga studentët tanë, jo vetëm prej atyre të diplomuar në një nga fushat e ekonomisë, por edhe studentë të tjerë të cilët duan të formësojnë dijet e tyre në menaxhimin e sektorit publik, inovacion në bashkëpunimin aktorë sektorialë/ndërsektorialë-universitet, duke krijuar dhe fuqizuar kanalet e shkëmbimit të njohurive midis Universitetit dhe aktorëve në

funksion të fuqizimit të administratës publike. Ne terma afatgjatë, kjo do të rriste edhe ndikimin e Universitetit në fuqizimin e institucioneve publike në nivel lokal, rajonal dhe më gjerë.

Njëkohësisht, ky program zgjeron mundësitë për vazhdimësinë e studimeve në ciklin e tretë të studimeve në fushën e administrimit publik.

Në Planin strategjik të Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë si dhe në Planin Strategjik të zhvillimit të Fakultetit të Ekonomisë, janë të shprehura qartësisht Vizioni, Misioni dhe Objektivat Strategjike, dhe theksojmë se programi i studimit Master Shkencor në Administrim Publik është në përputhje të plotë me to.

✓ **Vizioni.**

Programi Masteri Shkencor në “Administrim Publik” është i orientuar në përgatitjen dhe aftësimin e studentëve për të qenë liderët e të ardhmes dhe administratorët publik të përkushtuar ndaj shërbimeve publike cilësore që shoqëria dhe ndërgjegjësimi social kërkon.

Përmes këtij programi kërkojmë të kontribuojmë në të ardhmen më të mirë akademike dhe profesionale për studentët tanë me qëllim që t’i shërbejnë më mirë komunitetit ku ata jetojnë dhe punojnë.

✓ **Misioni.**

Programi Master Shkencor në “Administrim Publik” është projektuar t’u ofrojë studentëve formim intelektual, aftësim profesional, duke parashtruar një shumëllojshmëri dijesh e njohurish mbi parimet e administrimit publik modern, politikave publike dhe të nxisë të menduarin kritik për menaxhim të suksesshëm të këtij sektori duke i’u pershtatur dinamikave që një elite e re punonjësish të administratës publike kërkon.

Qëllimi kryesor i Programit të Studimit Master Shkencor në “Administrim Publik” është krijuar për të siguruar studentët me cilësinë më të lartë të edukimit në përgatitjen për karriera, ose përparimin e karrierës, në organizata publike, jofitimprurëse, mjedisore dhe të kujdesit shëndetësor. Programi thekson përvetësimin e teorisë akademike dhe aftësive praktike për të nxitur një angazhim etik dhe të qëndrueshëm ndaj vlerave të shërbimit publik për t’i shërbyer interesit publik me përgjegjësi dhe transparencë; duke shërbyer në mënyrë profesionale me kompetencë, efikasitet dhe objektivitet; duke vepruar në mënyrë etike për të mbështetur besimin e publikut; dhe demonstrimi i respektit, barazisë dhe drejtësisë në marrëdhëniet me publikun; mbështetjen e praktikës së administratës publike dhe aftësinë e saj për t’i shërbyer interesit publik, me theks në nivelin lokal, shtetëror dhe rajonal.

✓ **Objektivat e programit.**

Objektivat e programit janë në funksion të ndryshimeve dhe zhvillimeve politike, ekonomike dhe shoqërore të vendit, të ndërgjegjësimit gjithnjë e në rritje që përfituesit e shërbimeve publike shfaqin kundrejt cilësisë, të nevojës për të patur administratë publike me specialistë të aftë dhe të kualifikuar, të zhvillimit të vrullshëm teknologjik si instrument që ndihmon në

organizimin, funksionimin e sektorit publik dhe ofrimin e shërbimeve duke shmangur burokracitë.

- Programi ka për qëllim aftësimin profesional të studentëve si punonjës të specializuar të administratës publike në të gjitha nivelet e saj, përmes njohurive teorike dhe praktike që marrin në lëndet e ndryshme të këtij programi.
- Zhvillimi i politikave publike dhe ndërgjegjësimi i shoqërisë sonë për shërbime publike të mira dhe cilësore janë sfidat që motivojnë studentët tanë në përgatitjen e tyre gjatë këtij programi.
- Të pajisë studentët me njohuri të përditësuara mbi organizimin, funksionet e administratës së sektorit publik, si dhe hartimin dhe implementimin e strategjive dhe politikave publike.
- Të aftësojë studentët përmes të menduarit kritik si dhe aplikimin e njohurive të përvetësuara në situata praktike me të cilat ndeshet sektori publik në ditët e sotme.
- Të orientojë studentët që të dinë të përdorin në mënyrë racionale teknikat ndihmëse në funksion të përmirësimit të cilësisë së vendimmarrjes autonome për zgjidhjen e të gjitha çështjeve të nderlikuara administrative.
- Programi Master Shkencor në “Administrim Publik” i bashkohet programeve të tjera që Departamenti i Biznesit ofron duke synuar konsolidimin e këtij departamenti, përmes ofrimit të programeve të studimit që kërkon tregu i punës, diktuar nga zhvillimi kulturor, social, ekonomik dhe teknologjik të vendit.
- Rritja profesionale e studentëve duke i përfshirë ata në proceset e kërkimit dhe projekteve të përbashkëta.
- Realizimi në mënyrë sa më cilësore të praktikave profesionale të studentëve në institucionet e sektorit publik e cila shërben si një mundësi për punësimin e tyre të ardhshëm.
- Përkushtimi i stafit akademik në drejtim të përmbushjes së standarteve të etikës në mësimdhënie dhe kërkimin shkencor.

✓ Mundësitë për punësim

Por çfarë mund të bësh me një Master në Administratën Publike? Dhe pse studentët duhet të zgjedhin këtë rrugë karriere? Punët e Administratës Publike janë shumë të dobishme, duke marrë parasysh që pas përfundimit të një diplome, ju mund të punoni për qeverinë si këshilltar i administratës publike, menjëherë i qytetit dhe madje mund të bëheni një kryetar bashkie një ditë. Studentët e pajisur me diplomën e fituar në përfundim të studimeve Master Shkencor në “Administrim Publik”, kanë mundësi punësimi në drejtimin e organizatave publike si dhe në të gjitha nivelet e administratës publike në nivel qendror dhe lokal, sektori jofitimprues, banka dhe kompani private që kanë bashkëpunim me sektorin publik. Gama e gjerë e njohurive që studentët përfitojnë në këtë program i bën ata të aftë të menaxhojnë organizatën publike, të ndihmojnë në hartimin dhe implementimin e politikave publike, analizues të buxhetit si dhe të vlerësojnë performancën institucionale.

Programi i Master Shkencor në Administratën Publike tingëllon me të vërtetë interesant dhe sfidues, ashtu si edhe puna në këtë fushë. Diplomat e Administratës Publike u kushtohen kryesisht njerëzve që e shohin veten si persona etikë dhe janë shumë të interesuar për të bërë një ndryshim për mirëqenien më të madhe të komunitetit.

Por çfarë mund të bësh me një Master në Administratën Publike? Dhe pse duhet të zgjidhni këtë rrugë karriere? Epo, punët e Administratës Publike janë shumë të dobishme, duke marrë parasysh që pas përfundimit të një diplome, ju mund të punoni për qeverinë si këshilltar i administratës publike, menaxher i qytetit dhe madje mund të bëheni një kryetar bashkie një ditë.

Përveç një kënaqësie personale, karrierat në Administratën Publike janë jashtëzakonisht të gjithanshme, duke ju lejuar të eksploronit punë në sektorë të ndryshëm të tregut, publik dhe privat gjithashtu. Përparësi të tjera të mëdha të vendeve të punës në administratën publike qëndrojnë në nivelin e tyre të lartë të sigurisë dhe stabilitetit dhe faktin që ju mund të përfitoni nga shanse të shumta për të kaluar në pozicione më të larta.

Programi i Studimeve të Masterit shkencor në "Administrim Publik" përfshin lëndë të detyruara dhe me zgjedhje, kryesisht në fushën e menaxhimit, të drejtës, politikave publike dhe financës publike. Kursi parashikohet të ketë 120 kredite (kohëzgjatje 4 semestra). Zhvillimi i lendeve do të realizohet në auditor: gjithashtu do të jenë përfshirë 12 kredite (ETCS) Teze e MSh dhe 6 kredite përfaqësohen nga 1 lëndë me Zgjedhje që studentet do të zhvillojnë në auditore dhe 12 Kredite (ECTS) programi i praktikës mësimore që synon thellimin e njohurive në auditor me kuptimin e proceseve që ndodhin në administratën publike, përmes krijimit të kontratave të partneritetit me institucione publike të lokalizuara në Rajon dhe më gjerë.

Kurrikula e këtij Masteri Shkencor do të zhvillohet nepermjet bashkepunimit të ekspertëve shkencor në fushat e menaxhimit, ekonomisë, drejtësisë, dhe financës publike të cilat janë thelbësore për çështjet që kanë lidhje me funksionimin e kuptimit në thellësi të proceseve që zhvillohen në administratën publike në nivel institucional dhe territorial kombëtar e lokal. Kurrikula do të sigurojë mundësitë për sigurimin e njohurive të mjaftueshme teorike dhe praktike, të kërkuara nga tregu i punës, të cilat do të shfaqin një impakt pozitiv në punësimin e studentëve dhe plotësimin e kërkesave të tregut të punës.

Të gjitha aktivitetet formuese të parashikuara në planin mësimor si dhe praktika për zhvillimin e tezës së diplomës i japin mundësi studentit të:

- Disponojë njohuri dhe aftësi të cilat i mundësojnë njohjen dhe menaxhimin e institucioneve publike;
- Zbatoni teoritë e menaxhimit, udhëheqjes dhe organizatës për të ofruar qeverisje efektive në organizatat publike dhe jofitimprurëse.
- Disponojë njohuri dhe aftësi për zbatimin dhe monitorimin e politikave publike;
- Disponojë aftësi të zbatojë arsyetimin etik për modelin administrativ dhe vendimmarrjen në kontekstin e menaxhimit dhe udhëheqjes publike.

- Të jetë kompetent për shërbimet publike, krijimin, ofrimin dhe standartet e tyre në përputhje me nevojat e komuniteteve lokale, rajonale dhe qëndrore.

Më poshtë jepet një përshkrim i shkurtër i njësisë bazë në Universitetin “Ismail Qemali” të Vlorës, që aplikon për këtë Program Studimi.

Departamenti i Biznesit, Fakulteti i Ekonomisë, në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë)

Krijimi i **Departamentit të Biznesit** përkon me hapjen e Universitetit të Vlorës “Ismail Qemali” si dhe çeljen e Fakultetit të Ekonomisë me vendim të Këshillit të Ministrave Nr.105, datë 28 Shkurt 1994.

Departamenti i Biznesit është i organizuar me dygrupe mësimore:

- Grupi Mësimor i Biznesit
- Grupi Mësimor i Marketing-Turizmit

Departamenti i Biznesit ofron programe studimi të ciklit të parë bachelor në degët:

- Bachelor “Administrim Biznesi”
- Bachelor “Manaxhim Turizmi”
- Bachelor “Marketing”

Programe studimi të ciklit të dytë Master Profesional dhe Master i Shkencave në degët

- Master Profesional “Administrim Publik”
- Master Profesional “Sipërmarrje në Turizëm”
- Master Profesional “Marketing”
- Master i Shkencave “Administrim Biznes”

Departamenti i Administrim Biznesit aktualisht ka 14 personel akademik me kohë të plotë, nga të cilët 5 profesorë të asociuar, 8 personel akademik me gradën Doktor i shkencave dhe 1 personel akademik në përfundim të doktoraturës. Krahas angazhimit për një mësimdhënie cilësore, personeli i departamentit është i angazhuar në një punë relativisht të gjerë studimore-shkencore e botuese, në funksion të procesit mësimor, duke dhënë njëkohësisht kontribut profesional në reformimin e ekonomisë së vendit, veçanërisht në fushën e marketingut, biznesit, turizmit dhe të administrimit publik. Një kontribut i vlerësuar është dhënë prej antarëve të tij në fushën e kërkimeve shkencore në formën e artikujve, monografive, konferencave shkencore, etj.

Departamenti ka marrëdhënie bashkëpunimi, në kuadrin e projekteve mësimore-shkencore, konferencave me një sërë departamentesh homologe jashtë vendit. Në të njëjtën kohë, ai kooperon edhe me një numër institucionesh vendase për çështje të ekonomisë dhe biznesit shqiptar. (Departamenti ka kontakte bashkëpunimi me mjaft departamente të universiteteve të huaja perëndimore në SHBA, Angli, Itali, Gjermani, Spanjë, Poloni, Portugali, etj.

Gjithashtu në Departamentin e Biznesit janë të angazhuar edhe pedagogët e jashtëm me përvojë e me gradë shkencore të universiteteve të tjera publike të cilët sjellin eksperiencën dhe ekspertizën e tyre praktike në mësimdhënie.

Dega “Biznes” ofron programe studimi të Ciklit të Parë Bachelor dhe të Ciklit të dytë Master Profesional dhe Master i Shkencave si më poshtë:

- Bachelor “Administrim Biznesi”
- Master Profesional “Administrim Publik”
- Master i Shkencave “Administrim Biznesi”

Ky propozim i ri vjen si rezultat i konsideratës që Programi i Master Shkencor në Administratën Publike tingëllon me të vërtetë interesant dhe sfidues, ashtu si edhe puna në këtë fushë. Diplomat e Administratës Publike u kushtohen kryesisht njerëzve që e shohin veten si persona etikë dhe janë shumë të interesuar për të bërë një ndryshim për mirëqenien më të madhe të komunitetit.

Por çfarë mund të bësh me një Master në Administratën Publike? Dhe pse duhet të zgjidhni këtë rrugë karriere? Epo, punët e Administratës Publike janë shumë të dobishme, duke marrë parasysh që pas përfundimit të një diplome, ju mund të punoni për qeverinë si këshilltar i administratës publike, menaxher i qytetit dhe madje mund të bëheni një kryetar bashkie një ditë.

Përveç një kënaqësie personale, karrierat në Administratën Publike janë jashtëzakonisht të gjithanshme, duke ju lejuar të eksploroni punë në sektorë të ndryshëm të tregut, publik dhe privat gjithashtu. Përparësi të tjera të mëdha të vendeve të punës në administratën publike qëndrojnë në nivelin e tyre të lartë të sigurisë dhe stabilitetit dhe faktin që ju mund të përfitoni nga shanse të shumta për të kaluar në pozicione më të larta.

- b) Të dhëna mbi kriteret e pranimit në këtë program studimi, tarifa dhe modalitetet financiare për studentët:

-Kriteret e pranimit në programin e studimit

Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së studentëve do të bëhen sipas procedurave të vendosura nga Ministria Arsimit Sportit dhe Rinisë (MASR), Rregullorja e studimeve në UV, Rregullorja e studimeve në Departamentin e Biznesit si dhe Rregullorja e brendshme e programit të studimit Master Shkencor në “Administrim Publik”.

- Fusha e studimeve paraardhëse (në rastet e programeve të ciklit të dytë).

Kontigjenti i konsideruar si target grup potencial, në universitetin “Ismail Qemali” të Vlorës, për regjistrimin në këtë program studimi janë studentët e gjithë departamenteve të Fakultetit Ekonomik dhe studentët e Departamentit të Drejtësisë, Shkenca Humane dhe Inxhinieritë. Duke marrë në konsideratë numrin kompleksiv të studentëve të viteve të treta në degët respektive të Fakulteteve dhe Departamenteve të sipërpërmendur, kontigjenti të cilit i adresohet mundësia për regjistrimin në Masterin Shkencor “Administrim Publik” është rreth 800 studentë. Nisur nga sa më sipër kuotat e parashikuara për këtë program studimi mendohet të jenë 50 (pesedhjetë).

Gjithashtu në Programin e Studimit Master Shkencor në “Administrim Publik” mund të regjistrohen vetëm personat që zotërojnë një diplomë të ciklit të parë (*bachelor*) ose diplomë të sistemit të vjetër në lëmin e ekonomisë, drejtësisë, inxhinieri (sipas profileve), dhe shkenca humane.

- Numri maksimal i studentëve që do të pranohen.

Gjykuar nga sa më sipër numri minimal i studentëve është 10 dhe maksimal 50.

- Dokumentacioni i aplikimit

Pranimi i kandidateve bëhet në pajtim me fushat dhe numrin e përcaktuar nga institucionet përkatëse (MASR, Rektorati i UV-es), përmes paraqitjes së dosjes personale të aplikantit sipas kriterëve të aplikimit të parashikuara me ligj dhe në rregulloren e Universitetit “Ismail Qemali” të Vlorës.

Kandidatët do të regjistrohen pranë sekretarise mësimore të Fakultetit të Ekonomisë, Universitetit “Ismail Qemali” të Vlorës. Dosjet shqyrtohen nga komisioni shkencor i programit të studimit, gjithashtu komisioni miraton edhe njohjen e krediteve të fituara nga kandidatët në studimet universitare. Për tu rregjistruar në programin mësimor të studimeve Master Shkencor në “Administrim Publik”, kandidati duhet të dorëzojë në sekretarinë e Departamentit këto dokumenta:

1. Diplomën e Shkollës së mesme.
2. Diplomën e shkollës së lartë
3. Transkriptin e notave
4. Fotokopje të kartës së Identitetit.
5. Dy foto portret.

- Tarifa e studimit

Kosto e përgjithshme të Masterit Shkencor deri në lëshimin e dëshmisë përkatëse duhet të jetë si më poshtë:

a) Për kandidatet që kryejnë brenda afatit normal të përcaktuar në planin mësimor paguhet vlera e tarifës e përcaktuar.

c) Për çdo zgjatje afati paguhet shtese vlerë tarife në përqindje të vlerës së tarifës të përcaktuar sipas krediteve të pashlyera.

Në këtë tarifë nuk përfshihen shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit gjatë lëvizjeve brenda ose/dhe jashtë vendit për vizita pune dhe kërkimore, të cilat duhet të mbulohen nga kandidati.

ANALIZA FINANCIARE E HAPJES SË PROGRAMIT MSc NË ADMINISTRIM PUBLIK

Realizimi i këtij programi do të bëhet i mundur brenda infrastrukturës mbështetëse ekzistuese të FE. Administrata aktuale e FE (sekretaria mësimore, laborantët) është e mjaftueshme për mbështetjen e studentëve të pritshëm. Nuk do të jetë e nevojshme të ngrihen laboratore të reja. Kostot shtesë që do të nevojiten për realizimin e këtij programi studimi do të jenë vetëm kostot e pagesës së orëve mësimore si dhe shpenzime të tjera për kancelari, materiale didaktike, bibliografi, etj.

Tarifa e studimit: 120.000 lekë për dy vite

Plani financiar i programit të studimit

Financimet (Hyrjet)		
Nr.i studentëve 20 minimumi 30 maksimumi 20 minimumi 30 maksimumi	Tarifa për: 1. Regjistrim 3000 Lekë 2. Shkollimi 120.000 Lekë	Totali Min = 60.000Lekë Max = 90.000 Lekë Min = 2.400.000 Lekë Max = 3.600.000 Lekë
TOTALI		Min = 2.460.000 Lekë Max = 3.690.000 Lekë

Tarifa e studimit për këtë cikël studimi është për llogaritur duke marrë në konsideratë shpenzimet e domosdoshme që do të nevojiten për ofrimin e këtij shërbimi, nivelin e përgjithshëm ekonomik të studentëve që frekuentojnë Universitetin “Ismail Qemali” Vlores si dhe duke marrë parasysh dhe nivelin e tarifave të programeve të tjera të ciklit të dytë në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë, e në universitetet e tjera publike që ofrojnë programe të ngjashme. Tarifa e regjistrimit bëhet zakonisht me postë (sipas udhëzimit të MAS). Ndërsa tarifa e shkollimit bëhet përpara fillimit të vitit akademik përkatës në bankë (sipas udhëzimeve të MAS).

Kostot e menaxhimit (daljet)	<i>Minimumi per 20 regjistrime</i>	<i>Max per 30 regjistrime</i>
Shpenzime per materiale didaktike, kancelari , bibliografike	100,000	150,000
Blerje materialesh te inventarizueshme	150,000	200,000
Shpenzime per promovimin e programit	100,000	120,000
Shpenzime per paga: Nëse orët mësimore realizohen si mbingarkesë e pedagogëve ekzistues, kostoja do të rezultonte si më poshtë: 1380 orë mësimore x 1120 L/orë = 1,545,600 L	1,545,600	1,545,600
Shpenzime per paga: Nëse orët mësimore realizohen si mbingarkesë e pedagogëve ekzistues, kostoja do të rezultonte si më poshtë: 1140 orë mësimore x 1120 L/orë = 1,545,600 L Në rast se orët mësimore realizohen nga 2 pedagoge te ftuar: 2ped.te ftuar x 120 ore/pedagog x 1360 leke/ore =	1,276,800 326,400	1,276,800 326,400
Shpenzime te tjera	20,000	30,000
Totali i kosos kur oret realizohen si mbingarkese e pedagogeve egzistues	1,915,600 Leke (1,915,600/20 = 95,780 L/st	2,045,600 Leke 2,045,600/30 = 68,186 L/st
Totali i kosos kur oret realizohen nga stafi egzistues dhe 2 pedagogeve te ftuar	1,973,200 Leke 2,131,600/20 = 98,660L/St	2,103,200 Leke 2,271,600/30 = 70,106 L/St

-Politika e mbështetjes financiare për studentët

- Në këtë kuadër është parashikuar të ndiqet praktika e trajtimit me bursa studimi për studentët ekselentë.

-Kuota të dedikuara për studentët të kategorive të veçanta.

- Për studentët e kategorive të veçanta do të ndiqen praktikat e parashikuara nga kuadri ligjor.

c) Plani mësimor/Kurikula e programit të studimit

Ky seksion duhet të paraqes një analizë të detajuar të kurrikulës së programit referuar në Standardeve Shtetërore të Cilësisë dhe kërkesave ligjore në fuqi, duke ju përgjigjur elementëve të mëposhtëm: Leksionet, seminarët dhe laboratorët do të zhvillohen në auditore dhe praktikë profesionale në terren, perkatesisht në entet publike në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar. Leksionet dhe seminarët janë të detyrueshme në masën 75 %. Programi i Studimeve Master Shkencor në “Administrim Publik”, me kohëzgjatje 2 vite i shtohet një formimi bazë të përfunduar paraprakisht. Ai u adresohet të diplomuarve që zotërojnë një diplomë të ciklit të parë (*bachelor*) ose diplomë të sistemit të vjetër në fushën e ekonomisë, drejtësisë, inxhinieri (sipas profileve), dhe shkenca humane. Më poshtë paraqitet Plani Mësimor i Masterit Shkencor në “Administrim Publik”

Tabela 3- Plani mësimor i Masterit Shkencor në “Administrim Publik” për të dy vitet e studimit										
Viti	Sem.	Kodi	Lënda	Kredi	Tot.orë / semes ter brend a& jashte audito rit	Tot. orë/ sem este r bre nda audi torit	Totali orë / jave ne auditorit (totali ore konsultime)			Totalio rëjashte auditori t
							lex	sem	lab	
Viti i pare	Sem. I	BIZ 451	Baza Qeverisje	6	150	60	3	1	0	90
		BIZ 455	Menaxhim Burimeve njerëzore në Administratën Publik	6	150	60	3	1	0	90
		BIZ 450	Njohuri bazë në administrim publik	6	150	60	3	1	0	90
		ECN 420	Ekonomiks Publik	6	150	60	3	1	0	90
		DRE 460	E drejtë administrative	6	150	60	3	1	0	90
		Totali			30	750	300	15	5	0
	Sem. II	FIN	Financë Publike	6	150	60	3	1	0	90
		BIZ 452	Planifikim Strategjik Administratën Publike	6	150	60	3	1	0	90
		ECN 410	Metodat e kërkimit në ekonominë e aplikuar	6	150	60	3	1	0	90
		BIZ 454	Etikë dhe Komunikim në Administratën Publike	6	150	60	3	1	0	90
		BIZ 453	Menaxhim i Institucioneve Publike	6	150	60	3	1	0	90
		Totali			30	750	300	15	5	0
Viti i dyte	Sem. I	MKT 512/FIN /BIZ	Marketing strategjik i avancuar/Financat e Qeverisjes Lokale/ Qeverisja elektronike	6	150	60	3	1	0	90
		BIZ 550	Vlerësimi i Politikave Publike	6	150	60	3	1	0	90
		BIZ 535	Marrje vendimesh	6	150	60	3	1	0	90
		BIZ 560	Menaxhimi i performancës në administratën publike	6	150	60	3	1	0	90
		BIZ 565	Menaxhim Projektsh	6	150	60	3	1	0	90
	Totali			30	750	300	15	5	0	450
	Sem. II	BIZ 539	Lidership	6	150	60	3	1	0	90
		BIZ 580	Praktikë profesionale	12	300	0	0	0	0	300
		BIZ 590	Tezë Diplome	12	300	0	0	0	0	300
		Totali			30	750	60	3	1	0
TOTAL I TË DY VITEVE				120	3000	960	48	16	0	2040

Në përfundim të lëndëve të detyrueshme, studentët duhet të zgjedhin 1 lëndë me zgjedhje me 6 kredite.
- Pasqyrë analitike për lëndë e kurikulës dhe krediteve si më poshtë:

- Lëndë të përgjithshme;
- Lëndë karakterizuese;
- Lëndë ndërdisiplinore/karakterizuese ;
- Lëndë plotësuese.

1. Kuadri i përgjithshëm formues i programit të studimit

Programi i studimit Master Shkencor në “Administrim Publik”					
NDARJA E LËNDËVE SIPAS TIPIT TË VEPRIMTARIVE FORMUESE		Nr.	Kodi	Lënda	Kredite
LËNDË TË FORMIMIT TË PËRGJITHSHËM (12 kredite) (5-10%)		1.	BIZ 450	Njohuritë bazë në administratën publike	6 kredite
		2.	BIZ 451	Bazat e Qeverisjes	6 kredite
LËNDË TË FORMIMIT KARAKTERIZUES (60 kredite) (50-60%)		3.	BIZ 452	Planifikimi strategjik në administratën Publike	6 kredite
		4.	BIZ 453	Menaxhimi i Institucioneve Publike	6 kredite
		5.	BIZ 454	Menaxhim Projektsh	6 kredite
		6.	BIZ 455	Menaxhimi i Burimeve Njerëzore në Administratën Publike	6 kredite
		7.	BIZ 560	Menaxhimi i performancës në administratën publike	6 kredite
		8.	BIZ 565	Etikë dhe komunikim në Administratën Publike	6 kredite
		9.	BIZ 550	Vlerësimi i politikave publike	6 kredite
		10.	BIZ 535	Marrje Vendimesh	6 kredite
		11.	BIZ 539	Lidershipi dhe performanca e grupit	6 kredite
		12.	ECN 420	Ekonomiks publik	6 kredite
LËNDË INTEGRUESE / NDËRDISIPLINORE (18 kredite) (12-20%)	Nëndisiplina/profile	13.	ECN 410	Metodat e kërkimit në Ekonominë e Aplikuar	6 kredite
		14.	DRE 460	E drejtë administrative	6 kredite
	Me zgjedhje	15.	BIZ 575/ MKT 575	Qeverisje Elektronike/ Marketing strategjik i avancuar	6 kredite
D. LËNDË PLOTËSUESE gjuhë të huaj, aftësi informatike, aftësi komunikuese ose prezantuese apo praktika – 12 kredite		16.	BIZ 580	Praktikë profesionale	12 kredite
E. DETYRIME PËRMBYLLËSE – 12 kredite		17.	BIZ 590	Tezë Diplome	12 kredite

Në programin e studimit parashikohen 1) Leksione, 2) Ushtrime 3) Seminare, 4) Praktikë profesionale

- Praktika profesionale.
- Detyrime përmbyllëse
- Tema e diplomës/provimi i përgjithshëm përfundimtar.

ç) Personeli akademik dhe ndihmës akademik

Në këtë seksion shtjellohet një përmbledhje e shkurtër mbi personelin akademik dhe ndihmës akademik të përfshirë me programin e studimit, duke përfshirë informacion mbi:

Personeli akademik që mbulon programin mësimor			
Nr.	Emër Mbiemër	Titulli akademik/ Gradë Shkencore	Lëndët
1.	Fioralba Vela	Profesore e Asociuar	Menaxhimi i organizatave publike
2.	Albert Qarri	Profesor Doktor	Metodat e Kërkimit në Ekonomine e Aplikuar
3.	Ilirjan Lipi	Profesore e Asociuar	Menaxhimi i burimeve njerëzore në administratë publike
4.	Amali Cipi	Doktor Shkencash	Njohuritë bazë në administratë publike
5.	Amali Cipi	Doktor Shkencash	Menaxhim projektsh
6.	Doriana Feimi	Doktor Shkencash	Lidership
7.	Doriana Feimi	Doktor Shkencash	Etikë dhe Komunikim në Administratë Publike
8.	Enida Pulaj	Doktor Shkencash	Planifikim Strategjik në Administratë Publike
9.	Enida Pulaj	Doktor Shkencash	Marrje vendimesh
10.	Zamira Sinaj	Doktor Shkencash	Menaxhimi i performancës në Administratë publike
11.	Arben Hysi	Doktor shkencash	Bazat e qeverisjes
12.	Xhiliola Agaraj	Profesore e Asociuar	Marketing Strategjik I Avancuar
13.	Rezarta Hasanaj	Doktorante	Vleresimi I Politikave Publike
14.	Rezarta Hasanaj	Doktorante	Qeverisja elektronike
15.	Lorena Alikaj	Doktor Shkencash	Ekonomiksi publik
16.	Veronika Dyrmishi	Doktor Shkencash	Finance Publike
17.	Loreta Alushaj	Doktor Shkencash	E drejte Administrative
18.	Fioralba Vela	Profesore e Asociuar	Praktike profesionale
19.	Fioralba Vela	Profesore e Asociuar	Tezë Diplome

d) PERSONELI AKADEMIK DHE NDIHMËS AKADEMIK

- Numri i personelit akademik që i dedikohen programit të studimit (personel efektiv dhe jo efektiv).
- Numri i personelit akademik të përfshirë në lëndët karakterizuese (personel efektiv dhe jo efektiv).
- Numri i personelit ndihmës akademik me karakter mësues në funksion të programit të studimit.

Personeli Akademik dhe ndihmes akademik	Departamenti i Biznesit (UV)	Numri Personelit Akademik që i dedikohet programit të studimit	Numri Personelit Akademik në Lëndët Karakterizuese	Numri i personelit ndihmës akademik me karakter mësues
Efektiv	8	13	8	1
Jo efektiv	0	0	0	

- CV e shkurtuar (bio) e personelit akademik nga IAL, që do të angazhohet në program (titulli/grada, fusha e ekspertizës kërkimore), angazhimin në program të personaliteteve të spikatura të fushës së studimit, etj.

Prof. Asoc. Fioralba Vela – Drejtuese e Departamentit të Biznesit

Lindur më 09/05/1976, Elbasan, Shqipëri

Mob. +355672035075, E-mail: fiorivela@yahoo.it; fioralba.vela@univlora.edu.al

Fioralba Vela, prej vitit 2016 mban titullin Professore e Asociuar, dhe prej vitit 2012 Doktore e shkencave ekonomike në fushën e menaxhimit dhe administrimit publik, mbrojtur me punimin shkencor të titulluar : "Menaxhimi i zhvillimit të infrastrukturës në Shqipëri. Plane, projekte dhe politika" Në vitin 2004 ka mbaruar studimet Master në "Menaxhim, Ekonomi dhe Drejtësi e Qeverisjes së territorit në Bashkimin Europian" me projekt final "Politikat rajonale dhe roli i Provincës në hartimin e politikave të transportit publik lokal. Rasti i Provincës së Barit", Universiteti "LIUC" Castellanza, Itali. Aktualisht është emëruar në detyrën e Drejtueses së Departamentit të Biznesit, dhe prej vitit 2016 – 2020 në pozicionin e Zv. Dekanes së Fakultetit të Ekonomisë, si dhe prej vitit 2007 – 2009, Shefe e Departamentit të Turizmit, Universiteti i Vlorës.

Prof. Asoc. Dr. Fioralba Vela është lektore prej vitit 2000 në fushën e menaxhimit, administrimit publik dhe turizmit.

Ka qenë pjesëmarrëse dhe profesore e ftuar e disa programeve të shkëmbimit akademik dhe shkencor në universitete të huaja si në: SHBA, Slloveni, Poloni, Itali, Spanjë.

Aktiviteti i saj kërkimor shkencor është fokusuar kryesisht në fushën e vendimmarrjes publike në sektorët infrastrukturorë, dhe menaxhimin e zhvillimit të territorit. Pjesëmarrëse dhe autore e studimeve të paraqitura dhe botuara në shumë konferenca dhe revista periodike shkencore brenda dhe jashtë vendit, si në: Spanjë, Gjermani, Rumani, Turqi, Francë, Itali, Mali i Zi, Greqi, Bosnjë dhe Hercegovinë, Maqedoni, Kosovë, etj.

Koordinatorë dhe drejtues të disa projekteve shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare të financuara nga fondet e BE-së, me fokus analizën e problemeve dhe zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit të turizmit në Shqipëri.

Prof. Dr. Albert Qarri

Email: albert.qarri@univlora.edu.al

Diplomuar në vitin 1990 në Fakultetin e Ekonomisë, Universitetin e Tiranës. Në vitin 2001 ka marrë titullin Master në Ekonomi, Universiteti i Tiranës, dhe në vitin 2004 ka marrë gradën shkencore Dr. Në fushën e ekonomisë dhe statistikës. Në vitin 2009 ka marrë titullin akademik "Profesor i Asociuar", në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë dhe në 2011, atë të Profesor Doktor nga Universiteti i Tiranës. Prej vitit 1997 është lektor në lëndët e Statistikës Ekonomike dhe Ekonometrisë në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë.

Prej vitit 2011 – 2016, ka qenë në detyrën e Rektorit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë. Prej vitit 2016 e në vazhdim në detyrën e Dekanit të Fakultetit të Fakultetit të Ekonomisë.

Prof. Dr. Albert Qarri është autor dhe bashkautor i shumë artikujve shkencor të botuara në revista shkencore me faktor impakti dhe konferenca kombëtare e ndërkombëtare.

Dr. Amali Cipi

Lindur, më 09 Shtator 1977, në Vlorë, Shqipëri

Mob. +355672009906,

E-mail: amali.cipi@univlora.edu.al, amalia.cipi@gmail.com

Amali Cipi është Lektore në Universitetin e Vlorës "Ismail Qemali", Shqipëri. U diplomua (2000) si Administrator Biznesi, Profili Marketing në Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti i Vlorës, "Ismail Qemali". Studime PhD në Fakultetin e Ekonomisë me temën "Praktika te qeverisjes se korporatave ne Shqiperi: Trendet pas krizes boterore te vitit 2008" - në Universitetin e Tiranës. Lektore e lendeve Manaxhim Biznesit, Manaxhim Operacionesh dhe Manaxhim i Projekteve në Universitetin "Ismail Qemali" të Vlorës që nga viti 2008. Interesat kërkimore kryesore te saj përfshijnë praktikat e qeverisjes së korporatave dhe aplikimi I metodës Delphi. Ajo është autore në revista shkencore dhe punimet e saj jane prezantuar në konferenca ndërkombëtare. Ajo ka qenë Përgjegjëse e Departamentit të Administrim Biznesit dhe më vonë Zv. Dekane e Fakultetit të Ekonomisë, Universiteti i Vlorës.

Dr. Enida Pulaj

E-mail: enida.pulaj@univlora.edu.al

Enida Pulaj, u diplomua në vitin 2003, në degën Administrim Biznesi pranë Fakultetit të Ekonomisë në Universitetin e Vlorës. Përfunduar studimet e doktoraturës (2014) pranë Fakultetit të Ekonomisë, Universiteti i Tiranës me temën "Atraktiviteti i industrisë së ndërtimit në këndvështrimin e strategjive konkurruese të Porterit". Lektore në lëndët: "Menaxhimi i biznesit", "Menaxhim strategjik", "Planifikim strategjik në administratën publike" dhe "Marrje vendimesh menaxheriale".

Autore dhe bashkëautore në shumë punime shkencore, konferenca, ëorkshops, etj., në fushën e Menaxhimit.

Prof.Asoc.Dr. Ilirjan Lipi

E-mail: ilirjan.lipi@univlora.edu.al

Ilijan Lipi është pedagog në Departamentin e Administrimit Biznesit, Universiteti I Vlores "Ismail Qemali" prej vitit 1998. Ai ka përfunduar studimet Master në Administrim Biznesi, Fakulteti Ekonomik, Universiteti I Tiranës. Gradën Doktor I Shkencave në Ekonomi e ka marrë në vitin 2006 në Fakultetin Ekonomik, Universiteti i Tiranës.

Titullin akademik Profesor i Asociuar e ka marrë në vitin 2015 në Universitetin e Durrësit "Aleksander Moisiu".

Interesat e tij kryesore kërkimore përfshijnë: Menaxhimin e Biznesit, Menaxhimin e Burimeve Njerëzore; Biznesit ndërkombëtar; Zhvillimi i Planit të Biznesit; Menaxhimi i Burimeve Njerëzore në Administratën Publike; Sistemi i Informatimit të Menaxhimit.

Ai është autor i shumë punimeve shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare.

Kualifikimet e viteve të fundit janë:

1-Python, 2020

2-Administrim Eëbsite CMS, 2020

3-Ekspert Fiskale, 2019

4-Front End Developer, 2019

Profesore e Asociuar Xhiliola Agaraj (Shehu)

Email : xhiliola.agaraj@univlora.edu.al

Profesore e Marketingut, Departamentit të Biznesit, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti "Ismail Qemali" të Vlorës. Prof. Assoc Xhiliola Agaraj (Shehu) ka përfunduar (1998) studimet universitare, Diplomë 4-Vjeçare "Manaxher Biznesi – Profili Marketing" pranë Universitetit "Ismail Qemali" të Vlorës, studimet pasuniversitare Master i Nivelit të Dytë SHPU në Marketing (2006) dhe Doktoraturë në Marketing (2011) pranë Fakultetit të Ekonomisë Universiteti i Tiranës, prej vitit 2015 mban titullin Profesore e Asociuar. Lektore e marketingut pranë Universitetit "Ismail Qemali" të Vlorës prej 1998, personel akademik i ftuar pranë Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës prej 2017, personel akademik i jashtëm pranë Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan 2017-2019. Drejtuese e Departamentit të Biznesit, Fakulteti i Ekonomisë, 2012-2020, si dhe anëtare e Senatit akademik të UV. Kërkimi shkencor është i orientuar përgjithësisht drejt marketingut dhe turizmit por dhe fusha të tjera të ekonomisë. Është autore e disa artikujve shkencor të botuara në revista të njohura me faktor impakti si dhe autore e disa artikujve të referuara në konferenca ndërkombëtare. Prof. Assoc Xhiliola Agaraj (Shehu) ka marrë pjesë në disa projekte kombëtare dhe ndërkombëtare si kërkuese, koordinatorë apo eksperte e jashtme. Organizatore e disa seminareve apo konferencave në nivel njësie bazë apo kryesore si dhe drejtuese e grupit të organizimit të konferencës së parë të marketingut (Dhjetor 2018) në nivel departamenti në UV. Anëtare e komisionit të vlerësimit të doktoraturave në Departamentin e Marketingut, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, si dhe Departamenti i Marketingut, Fakulteti i Biznesit, Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës.

Dr. Dorjana Feimi

Lindur më 19.07.1984

dorjanafeimi@univlora.edu.al

Dorjana Feimi është Lektor prej 2008 në Universitetin e Vlorës "Ismail Qemali", Shqipëri. Ajo mori diplomën Master Shkencor në Ekonomi dhe Drejtësi nga Universiteti i Bolonjës,

Itali. Ajo është Doktor Shkencash (2015) në fushën e Menaxhimit, gradë e marrë pranë Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë, me temë: “Praktika e Inovacionit si një rrugë për rritjen e performancës në sektorin e Shërbimeve në Shqipëri: Industria Bankare dhe e Telekomunikacionit”.

Interesat kërkimore të saj përfshijnë praktikën e inovacionit dhe sjellja në organizatë. Ajo është autore në revista shkencore dhe punimet e saj janë prezantuar në konferenca ndërkombëtare.

Dr. Zamira Sinaj

Lindur, më 30 janar 1982 në Vlorë, Shqipëri

Mob. +355692087501,

E-mail: zamira.sinaj@univlora.edu.al , zamira.sinaj20@gmail.com

Zamira Sinaj u diplomua (2006) si Menaxher Turizmii, në Fakultetin Ekonomik, Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë. Studime Doktorature në Institutin e Studimeve Evropiane me temë: "Ndikimi i zhvillimit të biznesit midis Shqipërisë dhe Italisë në zhvillimin ekonomik dhe integrimin Evropian të Shqipërisë(Fokus rajoni i Vlorës” - në Universitetin e Tiranës.

Në 2016 mbrojti gradën shkencore “Doktor” në Universitetin e Tiranës. Pedagogë e lendeve: Menaxhimi i performancës, Administrim Publik Evropian, Zhvillimi i Planeve të Biznesit në Universitetin “Ismail Qemali” të Vlorës që nga viti 2014. Autore dhe bashkëautore në shumë punime shkencore, konferenca, ëorkshops që lidhen me menaxhimin, biznesin, administratën publike, planet e bizneseit, etj. Ka qenë pjesë e grupit organizator në Konferencë Ndërkombëtare në Universitetin e Vlorës.

Dr. Arben Hysi

Email : arben.hysi@univlora.edu.al

Arben Hysi është një ekonomist, i cili është interesuar kryesisht në çështjet e menaxhimit të institucioneve publike. Arben Hysi është diplomuar nga Universiteti "Eqerem Cabej", Gjirokastrë, në programin e studimeve 4 vjeçare të Administrimit Publik. Ai ka gjithashtu edhe gradën Doktor i Shkencave në Shkencat Ekonomike, në fushën e Administrimit Publik, nga Universiteti Evropian i Tiranës. Aktualisht, Arben Hysi është Lektor në Universitetin "Ismail Qemali", në Vlorë, Shqipëri, në fushën e Menaxhimit, Fakulteti i Ekonomisë, Departamenti i Administrimit të Biznesit. Ai është autor i shumë artikujve dhe studimeve të botuara në revistat shkencore. Punimet e tij janë prezantuar në konferenca ndërkombëtare.

Dr. Veronika DURMISHI

Lindur ,më 25 Nëntor 1961, në Vlorë, Shqipëri

Mob.+355692297687,

e-mail: veronika_durmishi@yahoo.com, veronika.durmishi@univlora.edu.al

Veronika Durmishi është diplomuar si Ekonomiste finance në 1984, në Fakultetin Ekonomik, Universiteti i Tiranës. Studime të thelluara pas universitare (ShPU), Master i Nivelit të Dytë në Financë, Fakulteti Ekonomik Tiranë (2003-2006).

Diplomë e nivelit të tretë, Kërkim shkencor në ekonomi: "Investimet e Huaja direkte- sfida dhe perspektiva. Rasti i Rajonit të Vlorës", Fakulteti Ekonomik Tiranë (2007-2012). Llogaritë e parë dhe Përgjegjëse e Degës së Financës, Ndërmarrja Riparim Shërbimi Vlorë (1984-1998).

Pedagoge e lëndëve: Bazat e kontabilitetit, Drejtim financiar, Bazat e financës, Kontabiliteti i kostos dhe drejtimit në Universitetin "Ismail Qemali" të Vlorës (1999-2009).

Pedagoge e lëndëve: Parimet e kontabilitetit, kontabilitet financiar, Drejtim Financiar, Financa Publike, Financat e qeverisjes vendore, Taksimi, Kontabiliteti i kostos dhe drejtimit, Bazat e financës, Standartet e kontabilitetit, Universiteti privat "Pavarësia" Vlorë (2009-2018).

Pedagoge e lëndëve: Drejtim i ndërmjetësve Financiar jobankarë, Financa Publike, Metodat moderne të pasurive të paluajtshme, Auditim, Kontabiliteti i kostos, Kontabiliteti publik, Parimet e kontabilitetit, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë (2018-në vazhdim).

Autore dhe bashkëautore në shumë punime shkencore, konferenca, ëorkshops që lidhen me financën, kontabilitetin, administratën publike, financat e qeverisjes vendore, etj.

Dr. Lorena Serjanaj

Lindur, më 23 Shtator 1984, në Vlore, Shqipëri

Mob. +355698695802, E-mail: lorena.alikaj@univlora.edu.al , lorenaalikaj@yahoo.com

Lorena (Alikaj) Serjanaj, u diplomua (2007) si Administrator Biznesi, në Fakultetin e Tregtisë pranë Universitetit të Vlorës "Ismail Qemali". Më pas vazhdoi studimet pas universitare në "Master European në Administrim Biznesi- Profili: Financë Ndërkombëtare", pranë Departamentit të Administrim Biznesit, Fakulteti Ekonomik (Pole ESG), Universiteti "Paris Graduate School of Management", Paris, Francë, në bashkëpunim me "Neë York College" në Athinë, Greqi. Nën udhëheqjen shkencore të Dr. Chris Holidis mbrojti me Sukses dizertacionin: *"Privatizimi, liberalizimi dhe sektori i telekomunikacionit në Greqi: Njëanalize kosto- përfitimi nga pikëpamja sociale"*.

Në vitin 2019 përmbylli me sukses studimet doktorale pranë Departamentit të Ekonomiksit, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, Shqipëri.

MBA Rezarta Hasanaj

Lindur, më 18 Nëntor 1982, në Vlorë, Shqipëri

Mob. +355692038877, E-mail:

rezrarta.hasanaj@univlora.edu.al, rezrarta.hasanaj@gmail.com

Rezarta Hasanaj ka përfunduar studimet e larta universitare në Universitetin La Verne, Kaliforni, USA, në degën Administrim biznesi. Po në këtë universitet ajo ka kryer dhe studimet master MBA Administrim biznesi [Menaxhimi i Zinxhirit të Furnizimit (SCM)] (2009).

Autor dhe bashkëautor në shumë punime shkencore, konferenca, ëorkshops, etj., që lidhen me manaxhimin, biznesin, lidërsip, SME-të, MCT-në etj.

Dr. LORETA TOZAJ

Lindur më 17.06.1979

loreta.alushi@univlora.edu.al

Loreta Tozaj është lektore prej vitit 2005 pranë Universitetit Ismail Qemali Vlore, Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë. Ajo është Doktor Shkence në fushën e Te Drejtës Publike, grade e fituar pranë Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, me temë "Te drejtat e njeriut në raport me zhvillimet teknologjike". Interesat kërkimore të saj përfshijnë te drejtën publike, qeverisjen publike dhe te drejtat e njeriut. Ajo është autore e shumë artikujve në revista shkencore ndërkombëtare dhe në konferenca ndërkombëtare.

e) INFRASTRUKTURA AKADEMIKE NË FUNKSION TË PROGRAMIT

Ky seksion përmban informacion të përmbledhur mbi infrastrukturën akademike në shërbim të programit të studimit.

Infrastruktura mbështetëse në dispozicion të celjes së programit Master i Shkencave në Administrim Publik

Fakulteti i Ekonomisë brenda të cilit zhvillon procesin mësimor Departamenti i Biznesit, pjesë e të cilit kërkohej të çelëte programi Master në Administrim Publik, disponon auditorë të përshtatshëm për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, ambiente për personelin akademik, ambiente për personelin administrativ, ambiente për Bibliotekën e Fakultetit ku përveç hapësirave të studimit, studentët mund të shfrytëzojnë kompjuterat dhe aksesimin e internetit në to.

Vitet e fundit vihet re rënie e numrit të studentëve në të gjitha programet që ofron Fakulteti i Ekonomisë e cila pasqyrohet në akomodimin më të mirë të studentëve nëpër auditorë. Referuar sipërfaqes së shfrytëzueshme, Godina e Fakultetit të Ekonomisë ka një sipërfaqe prej 2360 m² e shfrytëzueshme në 2 fasha orare ndërsa Biblioteka ka një sipërfaqe prej 250 m² me kapacitet 60 vende studimi. Studentët e programit “Master” në Administrim Publik parashikohet të realizojnë mësimin kryesisht në intervalin kohor 14.00 –20.00, duke krijuar mundësi studentëve për të shfrytëzuar ambientet dhe burimet e bibliotekës edhe gjatë këtij intervali.

Referuar, Vendimit Nr 418, datë 10.05.2017 “Për standartet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe degëve të tyre” Aneksi 1/C, Normativa e sipërfaqes së shfrytëzueshme e ndarë sipas fushave të studimit për Shkencat natyrore është 2.5m², referuar totalit të sipërfaqes së shfrytëzueshme për godinën e Fakultetit të Ekonomisë që është 2360 m², numri total i studentëve prites në ciklin e dytë të studimit është $2360/2.5 \text{ m}^2 = 944$ studente ndërsa numri total i studentëve të cilët ndjekin aktualisht programin Master është 430 studente (256 Master profesional + 174 Master i Shkencave).

Mjediset për Fakultetin e Ekonomisë përgjegjës për celjen e programit të ri të studimit.	Sasia	Sipërfaqja
Salla për leksione	11	985
Klasa për seminare	8	395
Salla për aktivitete promovuese		
Salla për praktikë lëndore/ profesionale		
Laboratorë për lëndët	1	80

Laboratorë informatike		
Salla interneti		
Salla për bibliotekë	1	250
Mjedis për fotokopjime, librari etj.		
Zyrë informacioni për studentët	1	20
Korridore/holle		405
Mjedise shlodhëse si kafeteri/ fast-food/etj.	Holli KI	150
Nyje hidrosanitare për studentët	10	80
Norma m²/për student	2360m²/ 430 studentë = 5.49 m²/student	
Mjediset për stafin:	Sasia	Sipërfaqja
Zyra për Dekanin/zyrë mbledhjesh	1	80
Zyra për sekretarinë mësimore	7	70
Zyra për departamentet	10	230
Zyra për personelin akademik të departamenteve	1	25
Zyrë për financën		
Zyrë për Njësinë e SBC		
Zyrë për Koordinimin dhe Mbështetjen ndaj Studentëve		
Zyrë për IT		
Nyje hidrosanitare për personelin akademik	2	20
Norma m²/për person	405 m²/ 30 persona = 13.5 m²/person	

Si konkluzion: në bazë të analizës së mësipërme, Departamenti i Biznesit i cili zhvillon aktivitetin mesimor-shkencor, pjese e Fakultetit të Ekonomisë, disponon gjithë kapacitetet e nevojshme (në staf me kohë të plotë, sipërfaqe në dispozicion, laboratorë) për realizimin e gjithë veprimtarive akademike të programit Master i Shkencave në Administrim Publik.

PROGRAMET E PËRBASHKËT

Ky seksion plotësohet **vetëm nëse** programi i propozuar ofrohet në bashkëpunim me një institucion tjetër duke përfshirë edhe një përshkrim të nivelit të bashkëpunimit, duke ju përgjigjur elementëve të mëposhtëm:

- Burimet financiare.
- Kontributi i partnerëve.
- Vënia në dispozicion e burimeve nga partnerët.

- Administrimi i programit.
- Lëshimi i diplomës dhe lloji (diplomë e përbashkët/ e dyfishtë/e shumëfishtë)
- Të dhëna mbi aktin e themelimit/licencimit të institucionit partner në vendin e origjinës.
- Të dhëna mbi aktin e akreditimit të institucionit partner ose të programit të studimit
- Dokument zyrtar bashkëpunimi mes palëve, marrëveshja kuadër.
- Marrëveshja specifike për programin konkret të studimit.

f) Analizë e tregut të punës për Programin e studimit Master Shkencor në "Administrim Publik"

Në këtë seksion duhet të parashtrohet rezultati i studimit të tregut të punës për fushën përkatëse dhe ndërlidhja e programit të propozuar me trendin dhe nevojat e tregut të punës vendas dhe atij rajonal.

- Mundësitë aktuale
- Mundësitë për periudha afatmesme
- Politikat kombëtare të punësimit
- Trendi vendas dhe rajonal i punësimit referuar INSTAT, MFE, organizmave ndërkombëtare.
- Marrveshje, kërkesa paraprake nga operatorët

Analiza e tregut të punës

Transformimet ekonomike dhe politike që ka përjetuar sektori publik janë evidente. Tashmë qeveritë lokale kanë më shumë kompetenca dhe mund të ndikojnë në zhvillimin e rajonit që ato administrojnë. Në këto kushte, planifikimi, organizimi dhe zbatimi i planeve zhvillimore në nivelin e qeverisjes lokale dhe qendrore kërkon burime njerëzore të aftë për të përballuar sfidat me të cilat ndeshet sot sektori publik, si:

- Decentralizimi i menaxhimit publik
 - Fuqizimi i qeverisë lokale me në qendër reformën administrative dhe politike në vend,
 - Pavarësia për marrjen e vendimeve lokale që lidhen me aspekte si: planifikimi urban, zhvillimi ekonomik rajonal, përmirësim i vazhdueshëm i infrastrukturës, etj,
 - Ndryshimet në mentalitetin menaxherial në lidhje me shmangjen e ndryshimeve dhe prirjen për të ndërmarrë risk,
 - Rritja e partneritetit publik- privat,
 - Bashkëpunimet e vazhdueshme me partnere të huaj dhe vendas janë disa prej arsyeve që nëpunësit e administratës publike të kenë formimin e duhur në funksion të mbarëvajtjes së institucionit publik.
- Arsyeja kryesore për kryerjen e kësaj analize është mbledhja e argumentave që mbështesin vlefshmërinë e kësaj diplome në tregun e punës. Burimi kryesor i të dhënave mbi të cilat është bazuar kjo analize është kërkesa e lartë që studentët e diplomuar në një

prej degëve të profilit ekonomik por jo vetëm, kanë shprehur për diplomën Master në Administrim Publik.

- Në realitetin shqiptar, gjithnjë e në rritje ka shumë nevojë për punojës të kualifikuar të aftë t'i përgjigjen kërkesave në rritje në fushën e administrimit publik. Nga të dhënat mbi tregun e punës, sipas INSTAT (2019) vihet re se rreth 15.1% e të punësuarve i përket sektorit publik ndërkohë që raporti i punësimit në disa prej vendeve europiane për cdo 20 vende pune, 1 vend sigurohet nga organizatat publike dhe jo fitimprurëse.
- Në tre vitet e fundit, numri i rregjistrimeve në ciklin e dytë të studimeve Master Profesional në Administrim Publik, në UV ka qenë respektivisht 35 studentë në vitin akademik 2019-2020, 55 studentë të rregjistruar në vitin akademik 2018-2019 dhe 45 studentë të rregjistruar në vitin akademik 2017-2018.
- Një arsye tjetër që argumenton celjen e programit Master i Shkencave në Administrim Publik lidhet me kriteret e punësimit që Departamenti i Administrates Publike si dhe institucionet publike lokale, shpallin për vendet vakante referuar pajisjes së aplikantit me diploma të ciklit të dytë të studimeve Master I shkencave.
- Nisur nga sa më sipër del nevoja që institucionet publike të plotësohen me specialist të kualifikuar, me aftësi dhe shprehi praktike që i përket fushës së studimeve të avancuara përmes programit Master i Shkencave në Administrim Publik.
- Mungesa e kualifikimit të punonjësve, aktualisht të punësuar në institucionet publike, me orientim të theksuar praktik është një arsye tjetër që mund të çojë në përmirësimin e gjendjes aktuale dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve të ofruara në institucionet publike.
- Qëllimi kryesor i programeve të sotme të studimit është që të afrojnë sa më shumë programet universitare me tregun e punës. Në këtë logjikë, celja e këtij program ka për qëllim që të përgatisë studentët me njohuritë e duhura teorike dhe me aftësitë e duhura praktike qysh në auditore. Kjo është edhe arsyeja që shumica e lëndëve që janë të përfshira në program synojnë dhe po zbatohen nga një qasje praktike e profesionit pa mbetur thjesht në kuadrin teorik.
- Përvoja shumë vjecare e UV-së në fushën e ekonomisë, kapacitetet akademike të UV-së, marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet publike lokale dhe rajonale motivojnë celjen e programit Master i Shkencave në Administratën Publike.

Marrëveshje me institucione publike për punësim potencial të studentëve pas diplomimit.

Në mbështetje të realizimit të komponentëve mësimorë që përmban ky program, në vecanti komponentin e praktikës, por edhe për të mundësuar punësimin e studentëve pas diplomimit, janë nënshkruar këto marrëveshje nga njësia kryesore:

- Prefektura e Qarkut Vlorë
- Bashkia Vlorë
- Drejtoria Rajonale e Tatimeve, Vlorë
- Këshilli i Qarkut Vlorë
- Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Vlorë
- Drejtoria Rajonale AKU, Vlorë

Synohet që në të ardhmen të zgjerohet spektri territorial dhe institucional i krijimit të mundësisë për studentët të krijojnë një njohje më të thellë të elementëve praktikë të njohurive, para mbrojtjes së diplomës së Masterit.

S Strength	W Weaknesses	O Opportunities	T Threats
Cilësia e burimeve njerëzore siç dëshmohet nga përqindja e lartë e stafit me grada dhe tituj shkencor;	Konkurrenca midis larmisë së programeve të të njëjtit cikël në Fakultetin e Ekonomisë	Procesi i Anëtarësimit të Shqiperisë në Bashkimin Evropian me përfitime në krijimin e një administrate moderne dhe efikase	Rënie e numrit të studentëve si një fenomen jo i lidhur me programin e studimit por si një fenomen i përgjithshëm
Hapja ndaj inovacionit dhe përmirësimit të vazhdueshëm	Përfshirja më e madhe e institucioneve publike në jetën universitare	Përshtetimi i reformave institucionale	
Kapacitet i lartë për të përshtatur burimet njerëzore me strukturat specifike funksionale reformat që po ndodhin në Shqipëri	Përmirësim i vazhdueshëm i infrastrukturës	- Futja e standardeve të menaxhimit të cilësisë në administratën publike	
- Përshtatshmëria ndaj ndryshimeve ligjore		Përfitimet nga përvoja e shteteve anëtare të BE-së ose ato të rajonit	
- Mbeshtetje institucionale		Zhvillimi i partneritetit publik-privat	
Bashkëpunim dhe partnerite me IAL të huaja dhe institucione publike në rajon për zhvillimin e kurrikulave dhe praktikave mësimore		Kuadri ligjor për arsimin e lartë krijon mundësi për ofrimin e programeve akademike që i përgjigjen nevojave të tregut	
- Eksperianca dhe ekspertiza e stafit akademik në dhënie të konsulencës ndaj administratës publike		Ekzistenca e fondeve evropiane për projekte që lidhen me zhvillimin e infrastruktures në IAL	
- Përshtatje e programit të studimit me nevojat e tregut duke mbuluar një		Përfshirja gjithnjë e më shumë e burimeve	

gamë të gjerë veprimtarish dhe praktikash		njerëzore në administratën publike në projekte të huaja nga fondet e BE-së	
		Bashkëpunimi me vendet e tjera për trajnimin e administratës publike	
		Mundësia e arritjes së zhvillimit institucional përmes partneritetit me projekte të përbashkëta jashtë dhe brenda vendit	

**RAPORT FINAL I ANALIZËS SË TREGUT TË
PUNËS PËR CELJEN E PROGRAMIT MËSIMOR
MASTER SHKENCOR “ADMINISTRIM
PUBLIK”**

ZHVILLIMI I ADMINISTRATËS PUBLIKE NE SHQIPERI DHE KUADRI LIGJOR I ORGANIZIMIT TE SAJ

Reforma në administratën publike ka vazhduar të jetë në qendër të vëmendjes së qeverisë shqiptare, si pjesë e përpjekjeve të Shqipërisë drejt reformimit të shtetit. Bazuar në masat e reformës në administratën publike të përcaktuara, nën kontekstin e përgjithshëm strategjik, në Strategjinë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike 2015-2020, të ndryshuar dhe në Planin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, gjatë vitit 2018, qeveria shqiptare u fokusua në: - implementimin dhe garantimin e zbatimit rigoroz të legjislacionit për nëpunësin civil, në të gjitha institucionet e administratës shtetërore, nëpërmjet koordinimit me të gjitha njësitë e burimeve njerëzore për njohjen, unifikimin dhe mbikqyrjen e të gjitha procedurave për përmirësimin e performancës së administratës publike; - reformën funksional – strukturore të institucioneve të administratës publike, me fokus të veçantë në ristrukturimin e institucioneve të varësisë së Kryeministrit dhe ministrave të linjës.

Si rezultat, objektivat kryesore në lidhje me zhvillimin e administratës publike janë, si vijon:

1. Politikat në shërbimin civil, udhëheqje e reformës në këtë fushë, si dhe zbatimi i politikave të shërbimit civil në institucionet e administratës shtetërore
 - Përmirësimi i kuadrit rregullator, nëpërmjet miratimit të ndryshimeve në vendimet e Këshillit të Ministrave, në zbatim të ligjit nr. 152/2013, të ndryshuar.
2. Përmirësimi i procesit të përzgjedhjes dhe vlerësimit të kandidatëve që konkurojnë për t'u bërë pjesë e administratës shtetërore, nëpërmjet:
 - rritjes së kapaciteteve vlerësuese të anëtarëve të komiteteve të pranimit - trajnimi me metoda bashkëkohore për vlerësimin e kandidatëve;
 - pasurimit dhe përmirësimin cilësor të pyetjeve në bankën e pyetjeve;
 - bashkëpunimit me institucionet e arsimit të lartë, si dhe me përfaqësues të botës akademike me qëllim përthithjen e kandidatëve potencialë (studentët dhe të sapodiplomuarit) në administratën shtetërore;
 - përmirësimin të përshkrimeve të punës.

Klasifikimi i sektorit publik në Shqipëri¹

Proçesi i klasifikimit të sektorit publik në Shqipëri ka si qëllim klasifikimin e të gjithë njësive shpenzuese të klasifikuara në sektorin publik bazuar në Sistemin Evropian të Llogarive (ESA 2010), publikuar nga Instituti i Statistikave (INSTAT), Drejtoria e Llogarive Kombëtare. Lista e njësive shpenzuese të administratës publike përfshin të gjitha ato njësi të klasifikuara në sektorin e **Qeverisë së Përgjithshme**, sipas nën sektorëve:

Qeveria Qëndrore

Qeveria Federale²

Qeveria Lokale

¹ INSTAT, Republika e Shqipërisë, www.instat.gov.al

² Një ndarje e tillë nuk aplikohet në RSH

Fondet e Sigurimeve

Korporatat Publike Jo-financiare

Korporatat Publike Financiare

Duke qenë se ka ndryshime të shpeshta në emrat dhe numrin e njësive shpenzuese brenda Sektorit Publik, ky informacion përfshin përditësimet më të fundit të njësive shpenzuese, pjesë e sektorit publik. Klasifikimi i listës së plotë të njësive shpenzuese të sektorit publik është realizuar nga tre institucione :

1. Instituti i Statistikave (INSTAT)
2. Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE)
3. Banka e Shqipërisë (BSH)

Analiza e tregut të punës, në këndvështrimin e punëdhënësit, ka marrë në konsideratë kryesisht institucionet publike të cilat i përkasin kategorisë së Qeverisë së Përgjithshme, sipas nën sektorëve: Qeveria Qëndrore, Bashkia Vlorë. Në tabelën më poshtë jepet edhe struktura organizative e tyre, në terma të numrit të punonjësve të përfshirë në to, duke rritur në këtë mënyrë numrin potencial të tregut të studentëve potencialë të cilin do ta analizojmë në vijim.

Të punësuar në sektorin shtetëror sipas grupeve kryesore të profesioneve, 2015-2019 (në numër)

Grupet e Profesioneve	2015	2016	2017	2018	2019
Të punësuar ne sektorin shtetëror	164,020	164,635	164,339	169,865	172,745
Ligjvënës, nëpunës të lartë dhe drejtues	11,318	11,992	12,110	13,020	13,900
Specialistë	69,126	72,011	72,185	74,364	76,023
Teknikë dhe ndihmës specialistë	39,488	37,306	36,474	35,955	35,300
Nëpunës të thjeshtë	11,902	12,243	12,320	13,612	14,250
Punëtorë	32,186	31,083	31,250	32,914	33,272

Tabela 1. Të dhëna administrative³

³ INSTAT, www.instat.gov.al

Percaktimi dhe identifikimi i institucioneve publike te marra ne konsiderate per te realizuar studimin

Kjo analizë është fokusar në territorin e Bashkisë Vlorë, duke qenë se aktiviteti dhe ndikimi i Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë, është i përqëndruar pikërisht në këtë territor.

Tabela 2. Struktura e institucioneve publike, Bashkia Vlorë, 2020⁴

Nr	Emertimi i institucionit	Nr I punonjesve ne cdo institucion
1	Agjensia rajonale e sherbimit veterinar dhe mbrojtjes se bimeve	54
2	Bordi i Kullimit	30
3	Drejtoria Rajonale e Autoritetit Kombëtar te Ushqimit	27
4	Drejtoria Rajonale e Tatimeve	40
5	Dega Doganës Vlorë	27
6	Zyra Arsimore Selenice	195
7	Zyra Arsimore Vendore Vlore – Himare	998
8	Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombetare	35
9	Njesia Vendore e Kujdesit te Shendetit Publik	62
10	Drejtoria Rajonale e Fondeve te Kujdesit Shendetesor	34
11	Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqerore	99
12	Spitali Rajonal Vlorë	526
13	DROSHKSH	36
14	Spitali Psikiatrik Vlore	128
15	Zyra Permbarimit Vlorë	7
16	Paraburgimi Vlorë	137
17	ASHK	89
18	Qend. Traj. St. Vlorë sh.a	47
19	Drejtoria Rajonale e Rezervave Materiale te Shtetit	7

⁴ Burimi : Drejtoria Rajonale e Tatimeve, Vlorë

20	Zyra Rajonale e Punësimit	23
21	Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik.	7
22	Drejtoria Rajonale e Sherbimit Social Shteteror	8
23	Drejtoria Rajonale e Inspektoriatit Shteteror te Punes	9
24	Posta Shqiptare Vlorë	11
25	Drejtoria Rajonale e Sherbimit te Transportit	107
26	Oshee Vlorë	Nuk ka informacion
27	OSHEE , FZHU	Nuk ka informacion
28	TEC	62
29	Qendra e Trajnimeve Teknologjike Bujqesore	22
30	Zyra Vendore e Avokatit te Shtetit Vlore	Nuk ka informacion
31	INUK	Nuk ka informacion
32	Kapiteneria Portit Vlorë	11
33	Porti Detar Sh.A. Vlorë	121
34	Inspektorati i Peshkimit	4
35	Kantieri i Ndertimit te Anijeve	Nuk ka informacion
36	Zyra e Administrimit te Basenit Ujor Vjose	9
37	Dega Thesarit	9
38	Muzeu Kombetar Pavarsia	3
39	Drejtoria Shoqerive Publike	Nuk ka informacion
40	Dega e Agjencise Kombetare te Bregdetit	4
41	Administrata e Zonave te Mbrojtura	29
42	Inspektoratit Shteteror Shendetesor	24
43	Seksioni i Mobilizimit Rekrutimit Qarkut Vlore	5

2.2 ANALIZA E ARSIMIT TË LARTË NË RAJON DHE SHQIPËRI⁵

Pas një periudhe të zgjerimit të shpejtë gjatë dekadës së fundit, tani ka 240 IAL private dhe publike (universitete duke përfshirë fakultete, akademi dhe kolegje) në Ballkanin Perëndimor, duke siguruar 5,213 programe studimi. Pothuajse tre të katërtat e një milion studentëve janë regjistruar për të studiuar në këto IAL. Duke u rritur me shpejtësi gjatë dekadës së fundit, rritja e numrit të studentëve tani ka filluar të zbresë, përveç në Kosovë, ku zgjerimi vazhdon. Shqipëria dhe Kosova kanë më shumë studentë të regjistruar në raport me madhësinë e popullsisë sesa vendet e tjera.

Pas një sondazhi në të gjithë Ballkanin Perëndimor⁶, rreth 220,000 studentët e sapo regjistruar për të studiuar në IAL në vitin akademik 2013/14 dhe rreth 123,000 përfunduan studimet e tyre, duke dhënë një raport përfundimi prej 53%, që varion nga 33% në Kosova në 85% në Serbi.

28% e studentëve përfunduan studimet në fushat e Biznes, Administrim & Drejtësi, ndërsa 22% përfunduan studimet në Shkencë, Lëndët e teknologjisë, inxhinierisë dhe matematikës (STEM). Të diplomuarit janë mesatarisht të kënaqur me cilësinë e arsimit të lartë që morën, por shumë e perceptojnë se perspektivat e tyre të punës do të ishin përmirësuar me metoda më të mira të mësimdhënies, me kurrikula mësimore më cilësore dhe duke pasur profesorë më të kualifikuar.

Mbajtja e një diplome të arsimit të lartë ofron përparësi në tregun e punës. Mesatarja e shkallës së papunësisë së të diplomuarve të AL në rajon është 16.2% krahasuar me 23.9% për tërë fuqinë punëtore. Sidoqoftë, shkalla e papunësisë për të diplomuarit e rinj është 37.1%, duke treguar që të diplomuarit përballen me një kalim të vështirë nga IAL në tregun e punës. Në rajonin e Ballkanit Perëndimor tregu i punës, ka një furnizim të madh të të diplomuarve në shumicën e fushave të studimit, veçanërisht nga fusha e gjerë e studimit të Biznesit, Administratës dhe Drejtësisë. Sektorët me rritjen më të shpejtë të vendeve të diplomimit përfshin informacionin dhe komunikimin Teknologjike, Ndërtimi, Aktivitetet Financiare dhe të Sigurimeve, Profesionale, Shkencore dhe Aktivitete teknike dhe veprimtari të tjera të shërbimit. Punësimi për të diplomuarit është rritur relativisht i shpejtë në punëdhënësit mikro dhe të mëdhenj, dhe në një numër të vogël të rritjes së lartë ndërmarrjet (të ashtuquajturat "gazela") që priren të jenë NVM.

Në përgjithësi, në anën e HE, politikat e regjistrimit duhet të përqendrohen më shumë në nevojat e tregut të punës dhe në fuqinë punëtore nga ana e tregut, duhet të krijohen më shumë vende pune me aftësi të larta në sektorë me rritje të shpejtë duke tërhequr më shumë investime të huaja direkte, dhe duke mbështetur bizneset e vogla dhe mesme, për të siguruar më shumë punë për të diplomuar në AL.

^{5 5} From University to Employment: Higher Education Provision and Labour Market Needs in the Eastern Balkans Synthesis Report, European Commission Report, EILL BARTLETT, Milica UVALIĆ, Niccolo DURAZZI, Vassilis MONASTIRIOTIS and Tanguy SENE, 2015

⁶ From University to Employment: Higher Education Provision and Labour Market Needs in the Eastern Balkans Synthesis Report, European Commission Report, EILL BARTLETT, Milica UVALIĆ, Niccolo DURAZZI, Vassilis MONASTIRIOTIS and Tanguy SENE, 2015

Shumë të diplomuar në Ballkanin Perëndimor kanë një hyrje të pasigurt në tregun e punës dhe shpesh përjetojnë periudha të papunësisë para se të gjejnë punësim të qëndrueshëm. Ky tranzicion nuk ndihmohet nga një nivel relativisht i ulët bashkëpunimi midis IAL dhe punëdhënësit në lidhje me hartimin dhe rekrutimin e kurrikulës. Pak punëdhënës diskutojnë ndryshimet në programet mësimore në baza të rregullta. Megjithatë, shumica e punëdhënësve thonë se një bashkëpunim i tillë do të përmirësonte përputhjen e të diplomuarve me punën. Kjo sugjeron që mbështetja e politikave është e nevojshme për të inkurajuar më shumë një veprimtari të tillë bashkëpunuese. Kur kërkojnë punë, të diplomuarit mbështeten kryesisht tek familja dhe miqtë për të gjetur një punë. Të sapodiplomuarit pak përdorin mbështetje nga institucionet zyrtare siç janë qendrat e karrierës së IAL, ose Shërbimet Publike të Punësimit.

Një pengesë kryesore me të cilën përballen studentët në tranzicionin e tyre nga AL në tregun e punës është mungesa e përvojës së tyre të punës, e cila vlerësohet shumë nga vendimet e rekrutimit të punëdhënësit për të sapo diplomuar. Të diplomuarit me një përvojë të mëparshme të punës kanë më shumë gjasa të gjejnë punësim, se të tjerët. Në mënyrë që të lehtësohet hyrja e të diplomuarve në tregun e punës, bashkëpunimi i biznesit dhe IAL ve duhet të rritet, duhet të bëhen shërbime të drejtimit të karrierës së të diplomuarve të zhvilluara më mirë dhe duhet të sigurohen më shumë mundësi që studentët e TIK të fitojnë përvojë pune para hyrjes në tregun e punës, pas diplomimit.

Në përmbledhje, ndërsa vetëm 53% e studentëve përfundojnë programin e tyre të studimit; nga ato që përfundojnë kursin e tyre vetëm 52% gjejnë punë; dhe nga këto, vetëm 48% gjejnë një punë që është e përputhur mirë me nivelin e tyre të arsimit. Në mënyrë që sistemet e AL të japin një kontribut më të mirë në ndërtimin e kapitalit njerëzor dhe konkurrencën dhe rritjen e ekonomisë, nevojiten reforma të rëndësishme të sistemeve të AL dhe tregjeve të punës për të diplomuarit në AL, dhe bashkëpunimi më i mirë midis punëdhënësve dhe IAL-ve duhet të inkurajohet.

Rekomandimet e politikave në lidhje me AL në Ballkanin Perëndimor⁷

Arsimi i lartë

IAL-të duhet të modernizojnë kurrikulën dhe të përmirësojnë metodat e mësimdhënies duke promovuar qasje më të përqendruar të studentët për të mësuar bazuar në klasa të vogla diskutimi, prezantimet e studentëve, detyrat e punës në ekip, dhe ushtrime për zgjidhjen e problemeve analitike dhe praktike.

Qeveria duhet të heqë stimujt për IAL-të për të marrë shumë studentë duke vendosur numrin e studentëve që një IAL mund të regjistrojë në përputhje me kapacitetin për të ofruar arsim me cilësi të lartë. Vendosja e kriterëve më të rrepta për regjistrim, kushtet më strikte të progresit dhe mbështetja shtesë nga stafi mësimdhënës mund të kontribuojë në nivele më të mira të përfundimit të studimit.

⁷ From University to Employment: Higher Education Provision and Labour Market Needs in the Eastern Balkans Synthesis Report, European Commission Report, Eil BARTLETT, Milica UVALIĆ, Niccolo DURAZZI, Vassilis MONASTIRIOTIS and Tanguy SENE, 2015

Duhet të merren gjithashtu hapa për të luftuar korrupsionin në procesin e hyrjes përmes një transparence më të madhe në rregullore dhe procedura. Institucionet përkatëse duhet të forcojnë inspektimet, sigurojnë pajtueshmërinë me vlerësimin dhe rregulloret e vlerësimit më notë dhe të zgjerojnë fuqinë e komiteteve të etikës.

Kur nuk është vendosur tashmë, duhet të kryhen akreditimi i IAL dhe programeve të studimit dhe duhet të aplikohen masa rigorozë të sigurimit të cilësisë për të rritur cilësinë e shërbimeve të AL. Vlerësimi i jashtëm i IAL-ve duhet të kryhet në përputhje me Standardet dhe Udhëzimet Evropiane për Sigurimin e Cilësisë.

Rëndësia e programeve të studimit duhet të përmirësohet duke inkurajuar më shumë bashkëpunimin midis IAL dhe punëdhënësve në hartimin e planprogrameve, dhe nga ofrimi i mundësive të përvojës në punë dhe praktikave. Të kesh punëdhënës që marrin pjesë në bordet e fakulteteve mund të kontribuojë për të siguruar që studentët të jenë të pajisur me aftësitë e duhura të nevojshme për tregun e punës. Një bashkëpunim i tillë biznes – universitet duhet të synojë modernizimin dhe rregullimin e programeve mësimore dhe rezultatet e të mësuarit me ato të nevojshme për tregun e punës.

Qeveritë duhet të përdorin bursa për t'i drejtuar studentët drejt përparësisë subjekte të tilla si subjektet STEM dhe larg subjekteve të mbingarkuara si p.sh. Biznes, Administrim & Drejtësi. IAL duhet të ofrojë më shumë informacion për aplikantët e mundshëm mbi kërkesën e mundshme të tregut të punës për programe të ndryshme studimi. Kjo mund të bëhet përmes programeve të informimit për shkollat lokale në partneritet me shërbimet publike të udhëzimit arsimor.

Qeveritë duhet të mbështesin të mësuarit sipërmarrës brenda IAL-ve kështu maksimizohen mundësitë që të diplomuarit të krijojnë bizneset e tyre të vogla të teknologjisë së lartë. Mësimi i sipërmarrjes duhet të bazohet në lidhjet me komunitetin e biznesit lokal.

Përvoja e punës e fituar përmes skemave të praktikës mund të jetë thelbësore në përmirësimin e perspektivave të punës në të ardhmen e të diplomuarve. IAL dhe punëdhënësit duhet të jenë inkurajuar të negociojnë më shumë vendosje të përvojave të punës me bizneset lokale në mënyrë që të diplomuarit të hyjnë në tregun e punës me ndonjë përvojë paraprake të punës nga praktikat.

IAL dhe shërbimet publike të punësimit duhet të ofrojë mbështetje për të përmirësuar të diplomuarit në kërkimin e tyre të punës për të siguruar që më shumë të diplomuar të gjejnë përputhjen e duhur punë – arsimim. Kjo është e nevojshme për të zvogëluar mbështetjen e familjes dhe miqve për të gjetur punë, dhe zvogëlojnë nepotizmin në tregun e punës për të diplomuarit. Paralelisht, IAL duhet të ndjekin destinacionet e punësimit të të diplomuarve të tyre sipas fushës së studimit, si mënyrë për të siguruar informacion mbi suksesin e të diplomuarve në gjetjen e një pune dhe për të mundësuar vlerësim më të mirë të nevojave të tregut të punës.

Tregu i punës

Duhet t'i jepet përparësi ngritjes së vetëdijes për rëndësinë e bashkëpunimit të punëdhënësit me IAL për rekrutimin dhe hartimin e kurrikulës. Qeveritë duhet të krijojnë programe për të lehtësuar bashkëpunimin midis IAL dhe punëdhënësit dhe duhet të veprojnë si ndërmjetës rrjeti për t'i afruar të dy palët së bashku. Duhet të vendosen programe të reja ose shtesë për të siguruar praktikë për të dy, studentët dhe të diplomuarit. Këto duhet të mbikëqyren me kujdes për të siguruar që të japin rezultate të dobishme të të nxënës.

Qeveritë duhet të mbështesin aktivitetin e NVM-ve⁸ me rritje të shpejtë në sektorë të njohurive intensive të teknologjisë së lartë. Ndërmarrje të tilla tentojnë të kenë një dendësi relativisht të lartë të punësimit të të diplomuarve. Kjo mund të bëhet përmes sigurimit të financimit me kosto të ulët përmes sistemeve bankare, në partneritet me fondet dhe programet e BE – së.

Qeveritë duhet të inkurajojnë konkurrencën dhe të heqin pengesat për hyrje për ndërmarrjet e reja të teknologjisë së lartë duke krijuar hapësira mbështetëse për inkubatorët e biznesit miqësore për të sapo diplomuarit dhe qendrat fillestare në hapësirat publike në nivele të ulëta kostoja e qirasë. Këto duhet të jenë të lidhura ngushtë me IAL lokale dhe bashkëpunimin midis IAL dhe ndërmarrjeve të reja fillestare duhet të inkurajohen, promovohen dhe mbështetetur.

Politikat aktive të tregut të punës (p.sh. aktivitetet e trajnimit) duhet të përqendrohen më mirë të sapodiplomuarit. Punëdhënësit duhet të inkurajohen të zgjerojnë trajnimin programe për rekrutët e rinj të diplomuar përmes zbritjes së taksave të kostove të trajnimit i sponsorizuar nga punëdhënësi dhe përdorimi i subvencioneve të trajnimit ose kuponëve. Trajnimi për firmat mikro, të vogla dhe të mesme që punësojnë të diplomuar dhe kanë furnizim lidhjet me investitorët e huaj duhet të kenë përparësi. Qeveritë duhet të financojnë skemat e trajnimit të diplomuar për NVM-të që kërkojnë shumë njohuri, të cilave u mungojnë burimet financojnë skema të tilla.

SFIDAT E ARSIMIT TË LARTË NË SHQIPËRI

Në vitet e fundit Shqipëria përjetoj një zgjerim të shpejtë të sistemit të saj të Arsimit të Lartë, duke përfshirë krijimin e disa IAL-ve të reja publike dhe private. Megjithatë, pas reformave të fundit dhe mbylljet e disa IAL private, Shqipëria tani ka 1.3 IAL për 100,000 të popullsisë ekuivalente me mesataren për Ballkanin Perëndimor. Edhe pse numri i studentëve në sistemin e AL⁹ është pothuajse trefishuar gjatë dhjetë viteve të fundit, cilësia e AL, mbetet e dobët meqenëse niveli i financimit publik nuk është rritur në përputhje me numrin e studentëve.

Çdo rreth 55,000 studentë regjistrohen në të gjitha nivelet e studimeve në 37 IAL, nga të cilat vetëm rreth 30,000 përfundojnë studimet e tyre çdo vit, duke dhënë një raport përfundimi prej vetëm 53%.

⁸ Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme

⁹ Arsimi i lartw

Ekziston një teprice e të diplomuarve me kualifikime në fushat e studimit të Shëndeti dhe Mirëqenia, Artet dhe Shkencat Humane, Biznesi, Administrata & Drejtësia dhe Edukimi; këto kombinohen me mungesa të të diplomuarve nga Shkencat e Natyrës, Matematikë dhe Statistikë, dhe Shkencë Sociale, Gazetari & Informacion. Kjo tregon se do të jetë e rëndësishme për të rregulluar përzierjen e të diplomuarve nga këto fusha studimi në të ardhmen.

Mësimdhënia vazhdon të mbështetet në mësimin në terren dhe kurrikulat e vjetruara, dhe ka një mungesë të arsimit të orientuar në praktikë. Pasoja është që të diplomuarit të mos arrijnë aftësitë që u duhen punëdhënësve.

NEVOJA PËR STUDIME NË ADMINISTRIM PUBLIK

Profesionistët e ardhshëm që janë të interesuar në fushën e administratës publike mund të përfitojnë nga mësimi më shumë rreth përbërësve aktualë të këtij programi diplomë dhe përfitimet e ndjekjes së tij si një fokus në karrierë. Administrata publike është një fushë gjithnjë e më popullore që u bën thirrje njerëzve që janë të interesuar të jenë pjesë e fushës së përhapur të shërbimit publik. Kjo mund të përfshijë shërbime të ofruara në nivelin lokal dhe shtetëror, ata që janë të përfshirë në shëndetin dhe sigurinë publike, qeverisjen lokale dhe arsimin.

Metoda më e mirë për t'u përfshirë në fushën e administratës publike është përmes marrjes së një diplome. Në nivele të ndryshme të gradave, studentët mund të mësojnë rreth financave, shërbimeve njerëzore, politikave dhe mirëmbajtjes së organizatave që i shërbejnë publikut. Nëse regjistrohesh në një program të tillë, ju gjithashtu mund të mësoni aftësi drejtuese që janë të rëndësishme për këtë lloj karriere dhe aftësi komunikimi që mund t'ju bëjnë të barazoheni me të tjerët në këtë fushë. Ndikimi juaj në këtë fushë mund të ndihmojë në rritjen e shërbimeve publike dhe organizatave që u krijuan për të ndihmuar shoqërinë me mjete të jetesës normale dhe të shëndetshme.

Ku mund të punoni me një gradë në administratën publike?

Tani që u njohët me fushën e administratës publike, mund të pyesni se çfarë lloji të punës mund të presin kandidatet potenciale të shohin si profesionist në këtë fushë. E vërteta është që specialistët e administratës publike mund të gjenden në shumë fusha të ndryshme në shoqërinë e përbashkët. Shumë profesionistë që mbajnë këtë gradë punojnë në poste qeveritare që kanë të bëjnë me zhvillimin e politikave më të mira për jetesën dhe mirëqenien. Të tjerët mund të gjejnë një përshtatje më të mirë në bizneset ose agjencitë jofitimprurëse që ndihmojnë në ofrimin e shërbimeve për publikun. Shumë udhëheqës brenda komunitetit aktual mund të kenë një arsimim në administratën publike, pasi ky program i diplomës është i përqendruar në nevojat dhe programet e pranishme në shoqëri.

Lista më poshtë përshkruan disa nga cilësimet e punës që janë të zakonshme për profesionistët në këtë fushë.

- Biznes: Profesionistët e ardhshëm që kanë interes në biznes mund të kenë mundësinë të përdorin një diplomë të administratës publike për të përmbushur dëshirat e tyre. Në

agjencitë publike dhe jofitimprurëse, profesionistët që kanë një arsim në administratën publike mund të ndihmojnë në zhvillimin e politikave të dobishme, menaxhimin e ekipeve të punonjësve dhe potencialisht madje të bëhen drejtues efektivë dhe të besueshëm. Pasja e një formimi të fortë në shitje dhe shërbim mund t'ju ndihmojë të merrni pozicione edhe më fitimprurëse në fushën e biznesit.

- Shërbimet Lokale / Qytetare: Meqenëse programet e gradave të administratës publike mund të përqendrohen në sigurimin e shërbimeve të mëdha publike për shoqërinë, të diplomuarit në këtë fushë mund të jenë një përshtatje e shkëlqyeshme për shërbimet lokale dhe të qytetit. Kjo mund të përfshijë pozicione në strehim, mirëqenie familjare, kujdes shëndetësor dhe shërbime civile. Meqenëse ekziston një varg i gjerë opsionesh të mundshme të karrierës për ata që marrin një diplomë në administratën publike, ka një larmi fushash brenda sistemit të qytetit që të diplomuarit mund të gjejnë një vend.
- Qeveria - Të gjitha nivelet: Pavarësisht nëse punoni në agjenci që specializohen në kërkime shoqërore dhe reforma apo kujdes shëndetësor, ka degë të qeverisë që mund të jenë të përshtatshme për të diplomuarit në administratën publike. Shtë e nevojshme që Qeveria e SHBA të sigurojë shërbime për publikun që kanë të bëjnë me përmirësimin e shërbimeve sociale, programe më të mira arsimore dhe udhëheqje të bollshme për agjenda të ndryshme politike. Nëse keni një interes në pozicionet qeveritare, kjo mund të jetë rruga për të ndjekur ju.

❖ *Objektivat e programit studimor Master Shkencor në "Administrim Publik"*

Objektivat e programit janë në funksion të ndryshimeve dhe zhvillimeve politike, ekonomike dhe shoqërore të vendit, të ndërgjegjësimit gjithnjë e në rritje që përfituesit e shërbimeve publike shfaqin kundrejt cilësisë, të nevojës për të patur administratë publike me specialistë të aftë dhe të kualifikuar, të zhvillimit të vullshëm teknologjik si instrument që ndihmon në organizimin, funksionimin e sektorit publik dhe ofrimin e shërbimeve duke shmangur burokracitë.

- Programi ka për qëllim aftësimin profesional të studentëve si punonjës të specializuar të administratës publike në të gjitha nivelet e saj, përmes njohurive teorike dhe praktike që marrin në lëndet e ndryshme të këtij programi.
- Zhvillimi i politikave publike dhe ndërgjegjësimi i shoqërisë sonë për shërbime publike të mira dhe cilësore janë sfidat që motivojnë studentët tanë në përgatitjen e tyre gjatë këtij programi.
- Të pajisë studentët me njohuri të përditësuara mbi organizimin, funksionet e administratës së sektorit publik, si dhe hartimin dhe implementimin e strategjive dhe politikave publike.
- Të aftësojë studentët përmes të menduarit kritik si dhe aplikimin e njohurive të përvetësuara në situata praktike me të cilat ndeshet sektori publik në ditët e sotme.

- Të orientojë studentët që të dinë të përdorin në mënyrë racionale teknikat ndihmëse në funksion të përmirësimit të cilësisë së vendimmarrjes autonome për zgjidhjen e të gjitha çështjeve të nderlikuara administrative.
- Programi Master Shkencor në “Administrim Publik” i bashkohet programeve të tjera që Departamenti i Biznesit ofron duke synuar konsolidimin e këtij departamenti, përmes ofrimit të programeve të studimit që kërkon tregu i punës, diktuar nga zhvillimi kulturor, social, ekonomik dhe teknologjik të vendit.
- Rritja profesionale e studentëve duke i përfshirë ata në proceset e kërkimit dhe projekteve të përbashkëta.
- Realizimi në mënyrë sa më cilësore i praktikave profesionale të studentëve në institucionet e sektorit publik e cila shërben si një mundësi për punësimin e tyre të ardhshëm.
- Përkushtimi i stafit akademik në drejtim të përmbushjes së standarteve të etikës në mësimdhënie dhe kërkimin shkencor.

Qëllimi i analizës është të studiojë kërkesat që ka tregu i punës për programin studimor Master Shkencor në “Administrim Publik” që synon formimin e profesionistëve të sektorit publik dhe jo vetëm, të aftë për të përmbushur shërbyer publikut në mënyrë korrekte dhe në përputhje me standartet e BE – së.

METODOLOGJIA

Metodologjia e përdorur është në funksion të qëllimit të analizës dhe konsiston në kombinimin e metodave cilësore dhe sasore. Të dhënat e mbledhura janë marrë përmes pyetësorëve të shpërndarë në të skajet e tregut të punës, me interes për programin e studimit Master Shkencor në Administrim Publik.

Jane hartuar dy pyetësorë për realizimin e këtij studimi tregu për programin Msc Administrim Publik, i cili synojmë të hapet në vitin akademik 2021 – 2022.

1. Pyetësor drejtuar aplikantëve Master Administrim Publik (bashkëlidhur këtij raporti). Përmes këtij pyetësori është synuar të identifikohen të dhënat demografike të aplikantëve potencialë, të cilët janë jo vetëm studentë të bachelor të degëve të ndryshme të përafërta ose jo me fushën e administrimit publik, por edhe të punësuar aktualisht në institucione, apo biznese. Janë plotësuar 100 pyetësorë, të cilët statistikisht janë të rëndësishëm për të artikuluar konkluzione dhe rekomandime të rëndësishme në orientimin drejt arsytimit të nevojës për celjen e programit, por gjithashtu edhe të aftësive dhe njohurive më të përshtatshme, nga këndvështrimi i studentëve.
2. Pyetësor drejtuar punëdhënësve (institucione publike – biznese) Përmes këtij pyetësori (bashkëlidhur këtij raporti) është synuar të matet nëse programi përmbush

nevojat e punëdhënësve për aftësimin e punëmarrësve potencialë të cilët kanë studiuar Msc Administrim Publik.

Gjatë hartimit të këtyre pyetësorëve është synuar të maten të gjithë treguesit që sic e kemi trajtuar në seksionin më sipër, për lidhjen mes arsimimit dhe punësimit, janë parë të rëndësishëm në këndvështrimin e studentëve dhe punëdhënësve.

Këto tregues janë si më poshtë:

- Bashkëpunimi me universitetet në diskutimin dhe hartimin e kurikulave të studimit
- Përputhja mes diplomës dhe punës
- Matja e aftësive dhe njohurive më të rëndësishme të nevojshme për një punë dhe përshtatja e kurrikulave me programe që plotësojnë këto njohuri dhe aftësojnë të sapodiplomuarit
- Ofrimi i praktikave mësimore për studentët e universitetit
- Rekrutimin e të diplomuarve përmes zyrës së karrierës së universitetit apo shërbimeve të informacionit të Universitetit
- Përpjekjet e IAL në mbështetje të atyre që synojnë të studiojnë Msc Administrim Publik.

Para se të shpërndahet pyetësori është përcaktuar madhësia e mostrës, ku popullata ka përfshirë jo vetëm studentë të programeve bachelor, kryesisht të Fakultetit të Ekonomisë, Universiteti i Vlorës, por edhe të punësuar tashmë në sektorin publik dhe atë privat, drejtuesit e të cilëve janë marrë në konsideratë për të matur atraktivitetin e këtij programi mësimor edhe nga këndvështrimi i punëdhënësve.

Pyetësorët u hodhën në programin google form, për të bërë të mundur shpërndarjen dhe plotësimin në kohë reale të tyre.

- Për studentët potencialë linku është shpërndarë në studentë, përmes adresave të tyre email, kryesisht të degëve të Fakultetit të Ekonomisë, por edhe të punësuar të institucioneve publike, apo private.
- Për punëdhënësit, janë përdorur kontakte personale dhe është kërkuar gjithashtu asistencë e Drejtorisë Rajonale Tatimore, Vlorë. Pyetësoret janë plotësuar në google form, por edhe hard copy.

Databaza e të anketuarve, për të matur perceptimet dhe interesin e shprehur për celjen e programit është e përbërë nga studentë dhe të punësuar, të cilët mund të kenë përfunduar ose jo studime të tjera master. Numri i pyetësorëve të plotësuar në mënyrë të rregullt është statistikisht i vlefshëm për të vazhduar kërkimin. Databaza e punëdhënësve aktualisht është 50 punëdhënës në institucione publike e private, që ofrojnë pozicione pune që përkojnë dhe i përshtaten të diplomuarve në këtë program studimi master, që kërkohet të celet. Databazat e përfutuara në excel janë hedhur në programin SPSS për përpunim të mëtejshëm.

Mbledhja e të dhënave primare përmes pyetësorit është realizuar në periudhën 17 Nëntor -3 Dhjetor. Metodologjia e përdorur është në funksion të kërimit. Është përdorur metoda e analizës sasiore. Në varësi të pyetjeve të strukturuar dhe në disa raste të matura me shkallë Likerti, është bërë analiza statistikore që i përshtatet informacionit të mbledhur nga pyetësoret e hartuar, si dhe mënyrës së matjes së të dhënave, të tilla si analiza krahasuese sipas përqindjeve, etj.

Analiza referuar të dhënave lidhur me studentët potencialë

Gjatë kësaj analize do të përqëndrohemi në çështjet kryesore që paraqesi interes të vecantë lidhur me matjen e faktorëve që identifikojnë shkallën e interesit të aplikantëve potencialë në programin e studimit Msc Administrim Publik.

Studimi sic e kemi thënë më sipër është kryer në studentët e programeve bachelor të Universitetit, kryesisht të degëve të Fakultetit të Ekonomisë, dhe gjithashtu edhe të punësuar të sektorit publik dhe atij privat.

Tabela 1. Shpërndarja sipas gjinisë

Gjinia	Frekuenca	Përqindja	Përqindja kumulative
Femër	80	74	74
Mashkull	28	26	100
Totali	108	100.00	

Pjesa më e madhe e të pyeturve, e cila i korrespondon edhe situatë demografike në Shqipëri, i përket gjinisë femërore 74%, dhe 34 % gjinia mashkullore, marrë prej pyetjeësorëve të vlerësuar të vlefshëm për të bërë analizën.

Tabela 2. Shpërndarja sipas moshës

Mosha	Frekuenca	Përqindja	Përqindja kumulative
Më pak se 20 vjec	6	5,59	5,59
20 – 22 vjec	26	24,07	29,66
22 – 25 vjec	12	11,11	40,77
25 – 30 vjec	14	12,96	53,73
30 – 35 vjec	20	18,51	72,24
35 – 40 vjec	20	18,51	90,75
40 – 45 vjec	10	9,25	100
45 vjec e lart	0	0	100
Totali	108	100	


Sic shihet edhe nga Tabela 2, pjesa më e madhe të pyeturve është në moshën 20 – 40 vjec, që është mosha aktive qoftë në studimet universitare, por edhe aktive në punë, dhe si rrjedhim e interesuar dhe në gjendje për të vazhduar studimet, sipas fushave të interesit, dhe nevojave të vendit të punës.

Tabela 3. Shpërndarja sipas notës mesatare të studimeve

Nota mesatare	Frekuenca	Përqindja (%)	Përqindja kumulative (%)
5 – 5.5	0	0	0
5.5 – 6	16	14.81	14.81
6 – 6.5	14	12.96	27.77
6.5 – 7	24	22.22	49.99
7 – 7.5	10	9.25	59.24
7.5 – 8	20	18.51	77.75
8 – 8.5	10	9.25	87
8.5 – 9	8	7.40	94.45
9 – 10	6	5.55	100
Total	108	100	

Figura 1. Shpërndarja sipas notes mesatare

■ 5 – 5.5 ■ 5.5 – 6 ■ 6 – 6.5 ■ 6.5 – 7 ■ 7 – 7.5 ■ 7.5 – 8 ■ 8 – 8.5 ■ 8.5 – 9 ■ 9 – 10



Sic shihet nga grafiku, pjesa më e madhe të anketuarve kanë notë mesatare në intervalin, (5.5 – 8), ku frekuenca më e madhe, sic evidentohet edhe ne Tabelen 3, i përket notës mesatare 6,5 – 8, që është pothuaj brenda kufirit të kriterëve të vendosura nga Universiteti i Vlorës për pranimin e studentëve në programet e studimit Master.


Tabela 4. Shpërndarja sipas nivelit të edukimit

Niveli i edukimit	Frekuenca	Përqindja (%)	Përqindja kumulative (%)
Diplomë profesionale	2	1.8	1.8
Diplomë e shkollës së mesme	28	21.8	23.6
Diplomë bachelor	50	45.5	69.1
Diplomë 4 – vjecare	10	10.9	80
Diplome master	18	16.40	96.40
Doktoraturë	0	0	96.40
Te tjera	4	3.6	100

Totali	108	100	
--------	-----	-----	--

Figura 2. Shperndarja sipas nivelit te edukimit

■ Diplomë profesionale ■ Diplomë e shkollës së mesme ■ Diplomë bachelor
 ■ Diplomë 4 – vjecare ■ Diplome master ■ Doktoraturë
 ■ Te tjera




Sic shihet edhe nga Tabela. 4 , përqindja më e madhe e të anketuarve i përket nivelit të edukimit në nivel bachelor 45,5% dhe kanë një diplomë të shkollës së mesme dhe po vazhdojnë studimet bachelor 21,8% e tyre, duke rritur pjesën potenciale të atyre që kanë nevojë dhe duan të vazhdojnë studimet Master.

Për të reflektuar shkallën e interesit të të anketuarve për vazhdimin e studimeve Master, na shërbejnë të dhënat e paraqitura në grafikun e mëposhtëm, i cili paraqet pikërisht frekuencën e shkallës së interesit për vazhdimin e këtyre studimeve.

Tabela 5. Frekuenca e shkallës së interesit për vazhdimin e studimeve Master

	Frekuenca e zgjedhjes	Përqindja (%)
Kam aplikuar për një program master	30	27.3
Ka shumë të ngjarë të aplikoj, dhe jam duke kërkuar në mënyrë aktive për opsione të ndryshme	28	25.5
